



PLANI/KORNIZA E MARRJES SË TOKËS DHE RIVENDOSJES SË MJETEVE TË JETESËS

Projekti: Ngrohtorja solare e
Prishtinës (Solar 4 Kosovo II)

Klienti:

Termokos Sh.A.

Data e dokumentit:

05 qershor 2026

KOPERTINA / FLETA INFORMATIVE E DOKUMENTIT

Projekti:	Ngrohtorja solare e Prishtinës (Solar 4 Kosovo II)
	KfW Development Bank (Banka Gjermane për Zhvillim (KfW))
Bashkë-financuar nga:	Palmengartenstr. 5-9, 60325 Frankfurt, Germany
	European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
	One Exchange Square, London EC2A 2JN, United Kingdom
Dokumenti:	Përditësimi 2024 – Plani / Korniza e marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit dhe rivendosjes së mjeteve të jetesës (PMTRJ/KMTRJ)
Përgatitur nga:	Termokos në bashkëpunim me ENOVA Sarajevo
Data:	Qershor 2026
Versioni:	Draft, versioni 5

Përmbajtja

1. Hyrje	8
1.1. Pasqyrë e projektit	8
1.2. Objektivat e këtij dokumenti	10
2. Korniza institucionale dhe legislative kombëtare	11
2.1. Korniza legislative kombëtare	11
2.2. Korniza institucionale kombëtare	13
3. Kërkesat e BERZH dhe KfW	14
3.1. Analiza e mangësive	15
4. Komponenti 1 – Lokaliteti i impiantit termik diellor	17
4.1. Lokacioni	17
4.2. Identifikimi i shfrytëzuesve të lokalitetit të impiantit termik diellor	17
4.3. Rezultatet e anketës socio-ekonomike	18
4.4. Përmbledhje e ndikimeve të pritshme	22
4.5. Masat zbutëse	22
4.6. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi	29
4.7. Orari tentativ i implementimit për komponentin 1	31
5. Komponenti 2 – Tubacionet e bartjes dhe lidhjes	32
5.1. Rreth Komponentës 2	32
5.2. Ndikimet e Pritshme	32
5.3. Metodologjia e Regjistrimit dhe Anketës Socio-Ekonomike	34
5.4. Matrica Paraprake e Të Drejtave	35
5.5. Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi	37
5.6. Orari Tentativ i Zbatimit për Komponentin 2	38
6. Komponenti 3 – Rrjeti i ngrohjes qendrore dhe nënstacionet	38
7. Angazhimi i palëve të interesit	39
8. Mekanizmi i ankesave	40
9. Shtojcat	42

PASQYRA E SHKURTESAVE DHE SHKURTIMEVE

BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KfW	gjerm. <i>Kreditanstalt für Wiederaufbau (Banka Gjermane për Zhvillim)</i>
KMTRJ	Korniza e marrjes së tokës dhe rivendosjes së mjeteve të jetesës
KP	Kërkesë e performancës
MPLLP	Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektet e BERZH-it
NQ	Ngrohje qendrore
NJIP	Njësi e Implementimit të Projektit
PAPI	Plani i angazhimit të palëve të interesit
PMTRJ	Plani i marrjes së tokës dhe rivendosjes së mjeteve të jetesës
PPP	Persona të prekur nga projekti
SMS	Standardi Mjedisor dhe Social (<i>Banka Botërore</i>).

Fjalorth termash

Ky fjalorth përkufizon termat dhe konceptet kryesore që përdoren në këtë dokument.

Data ndërprerjes	Data pas së cilës çdo person që vendoset në zonën e projektit nuk kualifikohet më për kompensim dhe/ose asistencë.
E drejta për kompensim	Kompensimi dhe asistenca që u takojnë personave të prekur nga projekti. Të drejtat për kompensim përcaktohen për secilin projekt individualisht.
Grupet e cenueshme	Këto grupe përfshijnë persona të cilët, për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjendjes së pafavorshme ekonomike ose statusit social, mund të preken më rëndë nga zhvendosja sesa të tjerët dhe mund të kenë kufizime në përfitimin nga ndihma për zhvendosje dhe përfitimet e zhvillimit që lidhen me të. Në kontekstin e zhvendosjes, grupet e cenueshme përfshijnë gjithashtu persona që jetojnë nën kufirin e varfërisë, persona pa tokë, të moshuar, familje me kryefamiljarë gra apo fëmijë, pakica etnike, komunitete që varen nga burimet natyrore, ose persona të tjerë të zhvendosur që nuk mbrohen nga legjislacioni kombëtar për kompensimin e tokës apo regjistrimin e pronësisë së tokës.
Kërkesa për Performancë 5 sipas BERZH: Marrja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme	Kërkesa për Performancë (KP) 5 trajton ndikimet që rrjedhin nga marrja e tokës në pronësi për nevoja të projektit, përfshirë kufizimet në përdorimin e tokës dhe qasjen në pasuri dhe burime natyrore, të cilat mund të shkaktojnë zhvendosje fizike (rilokim/zhvendosje, humbje toke ose humbje e strehimit) dhe/ose zhvendosje ekonomike (humbje toke, humbje pasurish ose kufizime në përdorimin e tokës, pasurive dhe burimeve natyrore që sjellin humbje të të ardhurave ose mjeteve të jetesës).
Kostoja e zëvendësimit	Një metodë vlerësimi që siguron kompensim të mjaftueshëm për zëvendësimin e pasurive, duke përfshirë edhe kostot e nevojshme të transaksionit që lidhen me zëvendësimin e pasurive (si shpenzimet për regjistrim, shërbime noteriale, udhëtim dhe çdo kosto tjetër që mund të lindë nga transferimi apo transaksioni i pronës). Kompensimi me kosto të plotë zëvendësimi është i mjaftueshëm për t'i mundësuar personit të prekur që të zëvendësojë tokën, strukturat dhe pasuritë e tjera me standard të njëjtë ose më të mirë në një lokacion tjetër.
Personat e prekur nga projekti (PPP)	Çdo person që, si rezultat i marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit, humb të drejtën për të zotëruar, përdorur ose përfituar në çfarëdo forme nga një strukturë e ndërtuar, tokë, pemë dhe të mbjella vjetore apo shumëvjeçare, apo çdo pasuri tjetër të paluajtshme apo të luajtshme, qoftë pjesërisht apo tërësisht, në mënyrë të përkohshme apo të përhershme.
Përmirësimi apo rivendosja e mjeteve të jetesës	Shtesa ose aktivitete të veçanta që synojnë të mbështesin personat e prekur në përmirësimin apo, së paku, rivendosjen e mjeteve të tyre të jetesës në nivelin që kishin para zhvendosjes. Kjo mbështetje mund të përfshijë: <ul style="list-style-type: none"> • kompensime për rivendosjen e aktiviteteve, të ardhurat e humbura gjatë periudhës së tranzicionit dhe shpenzimet për transferimin dhe riinstalimin e pajisjeve për personat që merren me aktivitete ekonomiko-tregtare; • pronë zëvendësuese ose kompensim monetar sipas koston së zëvendësimit për individët me të drejta të njohura ligjore mbi tokën; • kompensim sipas koston së zëvendësimit për pasuri jo-tokësore dhe asistencë për të rikthyer mjetet e jetesës në një vend tjetër për personat që nuk kanë pretendime ligjore mbi tokën; • kompensim për humbjen e burimeve natyrore në përdorim të përbashkët, përmes kompensimit në natyrë ose në para për humbjen e qasjes ose duke ofruar qasje në burime alternative;

<p>Plani i marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit dhe rivendosjes së mjeteve të jetesës (PMTRJ) dhe Korniza e marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit /rivendosjes së mjeteve të jetesës (KMTRJ)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • ndihmë të synuar për të përmirësuar ose rikthyer kapacitetin për të gjeneruar të ardhura dhe standardet e jetesës për individë dhe biznese të prekura; • mbështetje për personat e zhvendosur ekonomikisht gjatë periudhës së tranzicionit, bazuar në kohën e nevojshme për të rikthyer statusin e tyre ekonomik. <p>PMTRJ është një instrument që përshkruan procedurat dhe veprimet që do të ndërmerren për të zbutur ndikimet negative, për të kompensuar humbjet dhe për të ofruar përfitime zhvillimore për personat dhe komunitetet e prekura nga një projekt investimi. Qëllimi i tij është të tregojë saktësisht kush do të preket nga marrja e tokës në pronësi për nevoja të projektit, si do të realizohet procesi i marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit dhe nga kush, si dhe afatet kohore dhe burimet e nevojshme.</p>
	<p>KMTRJ është një instrument kornizë që zhvillohet kur natyra ose shkalla e saktë e marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit apo e kufizimeve në përdorimin e tokës nuk është ende e njohur për shkak të fazës së hershme të zhvillimit të projektit. Qëllimi i tij është të përshkruajë ndikimet e mundshme që lidhen me marrjen e tokës në pronësi për nevoja të projektit dhe të përvijojë parimet që do të ndiqen për t'i trajtuar ato.</p> <p><i>Shënim: Ky dokument është një PMTRJ/KMTRJ i kombinuar: Termi PMTRJ i referohet konkretisht ndërtimit të lokalitetit ku do të instalohen kolektorët termikë diellorë dhe vendosjes së gypave, ndërsa termi KMTRJ i referohet zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore për të furnizuar lagje shtesë, por zonat specifike ende nuk janë përkufizuar.</i></p>
<p>Regjistrimi, inventarizimi dhe anketa socio-ekonomike</p>	<p>Regjistrimi është një proces për mbledhjen e të dhënave nga 100% e individëve, ekonomive familjare dhe bizneseve (formale apo joformale) që do të zhvendosen fizikisht dhe/ose ekonomikisht si pasojë e një projekti. Inventarizimi paraqet një përshkrim të detajuar të pasurive të prekura, përfshirë tokën, objektet ndërtimore, të mbjellat/ pemët, infrastrukturën e përbashkët dhe burimet natyrore. Anketa socio-ekonomike përdoret për të identifikuar dhe analizuar gjendjen socio-ekonomike të individëve, ekonomive familjare dhe bizneseve (formale apo joformale) që do të zhvendosen fizikisht dhe ekonomikisht nga një projekt (<i>shih përkufizimet për zhvendosjen fizike dhe atë ekonomike më poshtë</i>).</p>
<p>Standardi jetësor</p>	<p>Përfshin të gjitha mënyrat përmes të cilave individët, familjet dhe komunitetet sigurojnë jetesën, si: pagat nga punësimi; të ardhurat në formë të parave të gatshme të fituara nga biznesi apo nga shitja e produkteve, mallrave, artizanatit apo shërbimeve; të ardhurat nga qiraja e tokave apo lokaleve; të ardhurat nga të korrat apo nga blegtoria, pjesa/hisja e të korrave apo prodhimit blegtoral; mallrat apo produktet e prodhuara vetë për këmbim apo konsum vetjak; ushqimi, materialet, lëndët djegëse dhe mallrat për përdorim personal apo shtëpiak, që rrjedhin nga burimet natyrore ose të përbashkëta; pensionet dhe llojet e ndryshme të shtesave që jepen nga qeveria.</p>
<p>Standardi Mjedisor dhe Social 5 sipas BB: Marrja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme</p>	<p>Standardi Mjedisor dhe Social 5 (SMS 5) fokusohet në zhvendosjen e pavullnetshme, me synimin që ajo të shmanget sa herë që është e mundur. Kur zhvendosja e pavullnetshme është e paevitueshme, ajo duhet të minimizohet dhe të merren masa të përshtatshme për zbutjen e ndikimeve negative mbi personat e zhvendosur (dhe komunitetet pritëse), përmes planifikimit dhe implementimit të kujdesshëm të ndërhyrjeve përkatëse.</p>
<p>Zhvendosja</p>	<p>Zhvendosja fizike dhe/ose ekonomike si rezultat i marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit dhe/ose kufizimeve në përdorimin e tokës.</p>
<p>Zhvendosja (ekonomike)</p>	<p>Humbja e pasurive (përfshirë tokën) ose e qasjes në to, që shkakton humbje të të ardhurave apo mjeteve të jetesës si pasojë e projektit. Individët apo</p>

Zhvendosja (fizike)

bizneset mund të përjetojnë zhvendosje ekonomike edhe pa pësuar zhvendosje fizike.

Humbja e shtëpisë, banesës apo strehimit si rezultat i marrjes së tokës në pronësi për nevoja të projektit, e cila kërkon që personi i prekur të shpërngulet në një vendbanim tjetër.

1. HYRJE

1.1. PASQYRË E PROJEKTIT

Projekti **Ngrohtorja Solare e Prishtinës - Solar 4 Kosova II** synon të rrisë kapacitetin e ngrohjes qendrore (NQ) në Prishtinë, me financimin e ofruar nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Projekti po implementohet nga Termokos, ofruesi kryesor i shërbimeve të NQ në Prishtinë. Projekti është miratuar zyrtarisht nëpërmjet akteve ligjore në vijim:

- **Ligji nr.08/L-222 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”,** e cila jep autorizimin ligjor për të vazhduar me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë, duke mundësuar implementimin e projektit.
- **Dekretet nr.11/2023 dhe nr.13/2023 për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, të nënshkuara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe KfW për Projektin e Ngrohtores Solare në Prishtinë.** Këto dekrete japin autorizimin ligjor për të vazhduar me termat e përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshja e Projektit.

Marrëveshja e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZH-it është miratuar zyrtarisht nëpërmjet Ligjit nr. 08/L-222 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe BERZH-it për projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”. Ky Ligj jep autorizimin ligjor për të vazhduar me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë, duke mundësuar implementimin e projektit.

Është krijuar një Njësi e Implementimit të Projektit (NJIP), e përbërë nga disa punonjës të Termokos-it dhe tre anëtarë të angazhuar posaçërisht nga projekti, për të menaxhuar dhe mbikëqyrur të gjitha aktivitetet e projektit.

Objektivat kryesore të projektit përfshijnë rritjen e eficiencës dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me NQ, reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në të gjithë rajonin. Projekti përbëhet nga tre komponentë kryesorë, secili me kërkesa të veçanta për tokë:

Komponenti	Nevojat për tokë
Komponenti 1: Ndërtimi i lokalitetit të kolektorëve termikë diellorë, që përfshin fushën e kolektorëve diellorë, rezervuarin sezonal të energjisë termike dhe pajisjet ndihmëse.	I vendosur në tokë publike të regjistruar në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të drejtë shfrytëzimi të dhënë Termokos-it, por aktualisht pjesërisht e shfrytëzuar për aktivitete bujqësore joformale.
Komponenti 2: Instalimi i dy tubacioneve të reja të bartjes (Korridori i Tubacionit A: 4.6 km dhe Korridori i Tubacionit B: 1.48 km). Tubacioni A do të lidhë lokalitetin e kolektorëve diellorë me rrjetin ekzistues të NQ në qendrën e qytetit, ndërsa Tubacioni B do të shërbejë si tubacion ndërlidhës, duke u shkëputur nga tubacioni ekzistues i transportit të energjisë termike për të dërguar ujin e ngrohur paraprakisht në impiantin diellor.	Planifikohet të instalohet në një kombinim të tokës publike dhe private.
Komponenti 3: Zgjerimi i rrjetit të NQ për të furnizuar lagje shtesë në Prishtinë	Zonat specifike për zgjerimin e rrjetit të NQ janë përkufizuar, ¹ por ende nuk është sqaruar pronësia e parcelave përkatëse.

Projekti është ende në fazën përgatitore. Projektimi i Projektit Paraprak është duke u finalizuar, ndërsa Projekti Kryesor ende nuk është zhvilluar.

¹ Lagjet e propozuara për implementim janë: Lakrishte, Tophane, Kalabria Dardha, Gjinaj Jug dhe Prishtina e Vjetër, dhe Mëhalla e Muhaxherëve.




Figura 1.1: Harta e komponentëve të projektit të planifikuar (burimi: CES)

1.2. OBJEKTIVAT E KËTIJ DOKUMENTI

Një **Plan/Kornizë paraprake për marrjen e tokës në pronësi dhe rivendosjen e mjeteve të jetesës (PMTRJ/KMTRJ)** u zhvillua në shkurt 2023, bazuar në informacionin e disponueshëm në atë fazë të projektit. Me avancimin e projektit, lindi nevoja për përditësimin dhe finalizimin e këtij dokumenti për të përfshirë informacionet më të fundit për projektin dhe për të integruar të dhënat e reja socio-ekonomike mbi personat e identifikuar si të prekur nga projekti (PPP). Prandaj ky dokument përfaqëson **versionin e përditësuar të PMTRJ/KMTRJ**.

Secili komponent i projektit është përshkruar në detaje në kapitullin përkatës brenda këtij PMTRJ/KMTRJ të përditësuar.

Shënim: Për qartësi, termi PMTRJ u referohet posaçërisht komponentëve 1 dhe 2, të cilët përfshijnë ndërtimin e impiantit termik diellor dhe instalimin e tubacioneve, ku ndikimet mund të analizohen në mënyrë të plotë dhe të përkufizohen strategji të synuara për zbutje. Nga ana tjetër, termi KMTRJ përdoret në lidhje me komponentin 3, i cili ka të bëjë me zgjerimin e rrjetit të NQ në lagje të reja; ky dokument shërben si kornizë udhëzuese për aktivitetet e ardhshme për marrjen e tokës në pronësi dhe rivendosjen e mjeteve të jetesës, pasi të identifikohen me përpikëri lokacionet dhe ndikimet përkatëse.

2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LEGJISLATIVE KOMBËTARE

Shënim: Ky seksion do të përditësohet për të ofruar një përshkrim të detajuar të procedurave të shpronësimit që janë relevante për komponentët 2 dhe 3 të Projektit, pasi të finalizohen detajet specifike për këta dy komponentë. Përditësimi do të përfshijë sekuencën e veprimeve që lidhen me procesin e shpronësimit, si: identifikimi dhe hartëzimi i pronave të prekura, njoftimi i pronarëve të tokës, vlerësimi i pasurive, përlogaritja e kompensimit, negociatat me pronarët dhe transferimi përfundimtar i pronësisë. Për më tepër, ky seksion do të tregojë mënyrën se si ky PMTRJ do të implementohet paralelisht me procesin e shpronësimit, me qëllim të sigurimit të koordinimit të duhur ndërmjet të dyve.

2.1. KORNIZA LEGJISLATIVE KOMBËTARE

Kushtetuta Republikës së Kosovës: Ndalon privimin arbitrar të pronës. Autoritetet mund të bëjnë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme:² Përvijon procedurat për marrjen e tokës në pronësi, përfshirë mjetet juridike për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet joproporcionale në të drejtën e pronës së paluajtshme. Kompensimi rregullohet si me këtë ligj, ashtu edhe me aktin nënligjor që përcakton metodat teknike dhe kriteret për vlerësimin e kompensimit.³

Vetëm personat me të drejta dhe pretendime të njohura ligjërisht mund të marrin kompensim. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës dhe përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit që mund të dëshmohet se është shkaktuar si pasojë e shpronësimit. Kompensimi bëhet në mjete monetare. Kompensimi në natyrë ose kompensimi i kombinuar (monetar dhe në natyrë) parashihet vetëm në raste të veçanta.⁴

Nuk implementohet asnjë ndryshim në të drejtat pronësore apo të tjera të personave të prekur para se të hyjë në fuqi Vendimi Përfundimtar për Shpronësimin dhe para se të bëhet kompensimi i parashikuar me Vendimin Përfundimtar.

Ligje të tjera relevante në Kosovë: Tabela më poshtë paraqet ligje të tjera me rëndësi (së bashku me aktet nënligjore përkatëse, të cilat nuk janë renditur individualisht këtu) që janë të aplikueshme në procesin e marrjes së tokës në pronësi.

Ligji	Përshkrimi
Ligji nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (2009)	Rregullon fitimin, përdorimin, mbrojtjen dhe pushimin e të drejtave të pronësisë dhe posedimit. Lejon kufizimin apo heqjen e këtyre të drejtave vetëm në interes të publikut, nën kushte të përkufizuara me ligj dhe në përputhje me parimet ndërkombëtare.
Ligji nr.08/L-237 për Kadastrën e pronës së paluajtshme (2024)	Rregullon regjistrimin e pronave të paluajtshme në kadastrë.
Ligji nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor (2013)	Vendos kornizën ligjore për përdorimin e tokës, planifikimin zhvillimor dhe rregullat e zonimit në Kosovë; udhëzon se si destinohet, zhvillohet dhe shfrytëzohet toka. Të gjitha projektet duhet të jenë në përputhje me planet e zhvillimit hapësinor.

² Ligji nr. 03/L-139 (i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L –205)

³ Udhëzim Administrativ (MF) nr. 02/2015 për Miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet, dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin

⁴ Në rastet kur autoriteti shpronësues është niveli qendror i qeverisë dhe kur është e nevojshme të shpronësohen më shumë se 20 parcela toke.

Ligji nr.04/L-110 për Ndërtimin (2012, i ndryshuar në vitin 2023)	Përcakton kornizën ligjore për të gjitha aktivitetet e ndërtimit, përfshirë standardet, lejet e ndërtimit dhe përdorimit dhe rregulloret që duhet të ndiqen gjatë zhvillimit të infrastrukturës.
Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme administrative (2016)	Ky ligj aplikohet si ligj ndihmës në procedurën e shpronësimit, krahas Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme. Rregullon procedurat që ndiqen nga autoritetet administrative kur vendosin për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. Palët kanë të drejtë ankimi ndaj vendimeve të shkallës së parë. Ligji gjithashtu lejon caktimin e një përfaqësuesi të përkohshëm, nëse, për shembull, adresa e pronarit të pronës që po shpronësohet është e panjohur.
Ligji nr.03/L-006 për Procedurën kontestimore (2008, i ndryshuar në 2012, i shfuqizuar pjesërisht me Ligjin nr.08/L-020 për Bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile)	Përcakton rregullat procedurale përmes të cilave gjykatat shqyrtojnë dhe zgjidhin kontestet civile ndërmjet personave fizikë dhe juridikë, përveç kur përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë.
Ligji nr.03/L-007 për Procedurën jokontestimore (2009, i ndryshuar në 2018)	Rregullon çështjen e përcaktimit të kompensimit për pronën e paluajtshme të shpronësuar në gjykata.
Ligji nr.5/L-021 për Mbrojtjen nga diskriminimi (2015)	Vendos një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, dhe ka për qëllim të parandalojë çdo veprim apo mosveprim të institucioneve shtetërore dhe lokale, personave fizikë dhe juridikë, në sektorin publik dhe privat, që cenon të drejtat e çdo personi fizik apo subjekti juridik. Ky ligj, ndër të tjera, garanton: (i) qasje në strehim që është i qasshëm për publikun dhe qasje në forma të tjera të pronës (të luajtshme dhe të paluajtshme), dhe (ii) trajtim të drejtë dhe të barabartë në procedurat gjyqësore dhe para të gjitha autoriteteve që administrojnë drejtësinë.
Ligji nr.05/L-020 për Barazinë gjinore.	Ka për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe juridike; promovon përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat dhe vendimet ligjore, duke siguruar barazi në proceset vendimmarrëse.

2.2. KORNIZA INSTITUCIONALE KOMBËTARE

Organizatat e renditura në tabelën më poshtë janë subjektet kryesore në nivel kombëtar që do të përfshihen në implementimin e PMTRJ/KMTRJ për projektin.

Subjekti	Përshkrimi
Termokos	Implementuesi i projektit – përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të këtij PMTRJ/KMTRJ; do të veprojë si përfitues i procesit të marrjes së tokës në pronësi.
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Departamenti i Shpronësimit: autoriteti shpronësues përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të marrjes së tokës në pronësi për këtë projekt.
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Departamenti i Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme / Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim: Autoriteti i vetëm përgjegjës për realizimin e vlerësimeve të pronës gjatë marrjes së tokës në pronësi, për përcaktimin e shumave të kompensimit për pronarët e prekur. Departamenti i Skemave Sociale: Menaxhon ndihmat dhe përfitimet sociale për personat e cenueshëm. Departamenti i Pensioneve: Mbron të drejtat pensionale dhe ofron ndihmë për grupet e cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe veteranët e luftës, për të ruajtur përfitimet e tyre.
Agjencia Kadastrale e Kosovës	Autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e regjistrimit të tokës dhe menaxhimin e sistemit kadastral kombëtar në Kosovë
Zyra Kadastrale e Komunës	Përgjegjëse për regjistrimin e tokës dhe pronave brenda juridiksionit përkatës; merret me aktivitetet e përditshme kadastrale, përfshirë përditësimet e të dhënave dhe lëshimin e certifikatave të pronësisë.
Komuna e Prishtinës	Komuna e Prishtinës, përmes Drejtorisë së Mirëqenies Sociale – Qendrës për Punë Sociale, pritet të mbështesë Termokos-in në identifikimin e grupeve të cenueshme të prekura nga procesi i marrjes së tokës në pronësi dhe procesi i zhvendosjes, si dhe të bashkëpunojë me Termokos-in për të siguruar që nevojat e këtyre grupeve të adresohen dhe që masat e zbutjes të implementohen në mënyrë efektive.
Komuna e Obiliqit	Komuna e Obiliqit, përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Qendrës për Punë Sociale, ofron përkrahje për individët dhe familjet e cenueshme. Komuna e Obiliqit, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – Qendrës për Punë Sociale, pritet të mbështesë Termokos-in në identifikimin e grupeve të cenueshme të prekura nga procesi i marrjes së tokës në pronësi dhe procesi i zhvendosjes, si dhe të bashkëpunojë me Termokos-in për të siguruar që nevojat e këtyre grupeve të adresohen dhe që masat e zbutjes të implementohen në mënyrë efektive.

3. KËRKESAT E BERZH DHE KfW

Ky kapitull përmbledh kërkesat kryesore të Kërkesës për Performancë 5 (KP 5) të BERZH-it dhe Standardit Mjedisor dhe Social 5 (SMS 5) të Bankës Botërore, të cilat aplikohen nga KfW në projektet e veta. Çdo projekt i financuar nga BERZH dhe/ose KfW kërkohet të jetë në përputhje me KP 5/SMS 5 BB.

KP 5 BERZH: Marrja e tokës në pronësi për nevoja të projektit, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme

Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it e vitit 2019 përfshin veçanërisht një Kërkesë për Performancë, KP 5, e cila ka për qëllim menaxhimin e ndikimeve të zhvendosjes, zhvendosjen e pavullnetshme dhe rivendosjen e mjeteve të jetesës. Kjo Kërkesë njihet se “nëse nuk menaxhohet siç duhet, zhvendosja e pavullnetshme mund të rezultojë në vështirësi afatgjata dhe varfëri për personat dhe komunitetet e prekura”. KP 5 aplikohet për të gjitha projektet që përfshijnë zhvendosje fizike apo ekonomike (shih *fjalorthin*), pa marrë parasysh përmasat e tyre dhe nëse janë të përhershme apo të përkohshme. Përveç marrjes së tokës në pronësi nga pronarët me të drejta të njohura, kjo përfshin edhe zhvendosjen e personave që nuk kanë të drejta formale, tradicionale apo të njohura sipas legjislacionit kombëtar, por që banojnë ose shfrytëzojnë tokën, pasuritë apo burimet natyrore (p.sh., persona që përdorin tokë publike në mënyrë joformale për aktivitete bujqësore). Gjithashtu përfshin edhe kufizimet në përdorimin e tokës që çojnë në humbje të qasjes në tokë, pasuri, burime natyrore apo mjete jetese, siç janë rastet kur kërkohen të drejta kalimi për ndërtimin e tubacioneve, ku toka shfrytëzohet përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit dhe më pas vendosen kufizime të përhershme gjatë operimit (p.sh., ndalim ndërtimi ose ndalim i pemëve të larta).

Parimet dhe kërkesat kryesore të KP 5 janë:

- Të shmangjet, ose të paktën të minimizohet, zhvendosja fizike apo ekonomike e shkakuar nga projekti kurdoherë që është e mundur, duke shqyrtuar alternativa të ndryshme të projektimit;
- kur zhvendosja është e pashmangshme, të zhvillohen dhe të implementohen plane veprimi të përshtatshëm për kompensim, zhvendosje dhe rivendosje të mjeteve të jetesës;
- të zbuten ndikimet negative nga marrja e tokës në pronësi, duke ofruar kompensim dhe/ose opsione për zhvendosje dhe rivendosje ose përmirësim të mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse ekzistojnë të drejta formale ligjore mbi tokën/strukturat apo jo;
- të mos përdoret kurrë dëbimi i detyruar;⁵
- të sigurohet kompensim për humbjen e pasurive sipas kostos së plotë të zëvendësimit, me kohë dhe përpara se të merret në posedim pasuria e përvetësuar, përveç në raste të caktuara kur kemi të bëjmë me: pronarë që janë larguar nga vendbanimi, refuzim të ofertave të drejta të kompensimit dhe procedime të zgjatura ligjore mbi pretendime që bien ndesh me njëri-tjetrin;
- të përmirësohen ose, së paku, të rivendosen mjetet e jetesës, kapacitetin për të gjeneruar të ardhura dhe standardin e jetesës për të gjithë personat e zhvendosur, përfshirë ata që nuk kanë të drejta ose pretendime ligjore të njohura mbi tokën;
- të sigurohet që kompensimi, zhvendosja dhe aktivitetet për rivendosjen e mjeteve të jetesës planifikohen dhe implementohen me dhënien e duhur të informacionit, konsultim dhe pjesëmarrje të informuar të personave të prekur;
- të bëhen rregullime të posaçme për të ndihmuar individët apo grupet e cënueshme, që mund të preken më negativisht nga zhvendosja dhe që mund të kenë kufizime për të kërkuar ose përfituar nga ndihma për rivendosjen e mjeteve të jetesës dhe përfitimet përkatëse të zhvillimit;
- të sigurohet që të drejtat për kompensim dhe realizimi i tyre marrin parasysh aspektet gjinore dhe ofrohen në mënyrë të barabartë për gratë dhe burrat dhe të përshtaten me nevojat e tyre specifike;

⁵ “Dëbimi i detyruar” i referohet zhvendosjes me shtrëngim të individëve, grupeve dhe komuniteteve nga shtëpitë, tokat dhe/ose burimet e përbashkëta (qoftë me pronësi të ligjshme apo të shfrytëzuara në mënyrë joformale), pa ofrimin dhe qasjen në forma të duhura të mbrojtjes ligjore dhe masave të tjera mbrojtëse, si dhe pa respektimin e kërkesave bazë të parashikuara nga politikat e organizatave ndërkombëtare financiare.

- të vendoset një mekanizëm ankesash për të pranuar dhe trajtuar me kohë shqetësimet specifike rreth kompensimit dhe rilokimit që ngrihen nga personat e zhvendosur, përfshirë një mekanizëm rekursi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të paanshme;
- të monitorohet procesi i marrjes së tokës në pronësi, zhvendosjes dhe rivendosjes së mjeteve të jetesës dhe të bëhen rregullime (veprime korrigjuese) për të arritur objektivat e politikave përkatëse.

SMS 5 BB: Marrja e tokës në pronësi për nevoja të projektit, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme

SMS 5 sipas Bankës Botërore trajton ndikimet që dalin nga marrja e tokës në pronësi dhe zhvendosja e pavullnetshme për shkak të projekteve, duke siguruar që efektet negative mbi individët dhe komunitetet të zbuten dhe minimizohen. Ashtu si edhe KP 5 sipas BERZH, SMS 5 aplikohet si në rastet e zhvendosjes fizike apo ekonomike të përkohshme, ashtu edhe në ato të përhershme, të shkaktuara nga marrja e tokës në pronësi ose kufizimet mbi përdorimin e saj. Një nga objektivat kyç të SMS 5, po ashtu si te KP 5 sipas BERZH, është të shmanget zhvendosja e pavullnetshme sa herë që kjo është e mundur. Kur zhvendosja është e pashmangshme, standardi kërkon që ndikimet e pafavorshme sociale dhe ekonomike mbi komunitetet e prekura të zbuten përmes kompensimit të drejtë dhe planifikimit të zhvendosjes. Kompensimi duhet të ofrohet sipas kostos së plotë të zëvendësimit, me përparësi për ofrimin e tokës së ngjashme si zëvendësim, kur është e mundur, dhe standardi ndalon shprehimisht dëbimin e detyruar. Mjetet e jetesës dhe kushtet e jetesës duhet të përmirësohen ose të paktën të rivendosen në nivelin para-projektit.

3.1. ANALIZA E MANGËSIVE

Janë identifikuar mangësi ndërmjet legjislacionit të Kosovës për shpronësimin dhe kërkesave të parashikuara në KP 5 BERZH / SMS 5 BB, si më poshtë:

- **Shmangia ose minimizimi i zhvendosjes:** Legjislacioni i Kosovës nuk përmban dispozita që kërkojnë shmangien ose minimizimin e zhvendosjes, ndryshe nga KP 5/SMS 5, të cilat kërkojnë shqyrtimin e alternativave të mundshme të projektimit për të shmangur ose së paku për të minimizuar zhvendosjen fizike dhe/ose ekonomike, duke balancuar kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe financiare.
- **Planifikimi i zhvendosjes:** Legjislacioni i Kosovës nuk kërkon hartimin e dokumenteve planifikuese për zhvendosje, siç janë korniza ose plani i zhvendosjes, të cilat janë të detyrueshme sipas KP 5/SMS 5.
- **Procesi i konsultimit:** Kriteret ligjore për marrjen e tokës në pronësi sipas legjislacionit të Kosovës parashikojnë konsultimet me palët e prekura, por jo në masën që kërkohet sipas KP 5/SMS 5.
- **Kriteret e kompensimit:** Kompensimi sipas legjislacionit të Kosovës ofrohet në vlerë tregu, ndërsa KP 5/SMS 5 kërkojnë kompensim sipas kostos së plotë të zëvendësimit, në mënyrë që personat e prekur të kenë mundësi të rivendosin mjetet e jetesës së tyre.
- **Shfrytëzuesit joformalë të tokës:** Sipas legjislacionit të Kosovës, shfrytëzuesit joformalë të tokës nuk gëzojnë të drejta për kompensim, ndërsa KP 5/SMS 5 parashikojnë shprehimisht dhënien e kompensimit për personat që shfrytëzojnë tokën pa të drejta formale, me qëllim që të mbështetet rivendosja e mjeteve të jetesës së tyre.
- **Rivendosja e mjeteve të jetesës:** Legjislacioni i Kosovës nuk kërkon përcaktimin e skenarit bazë duke mbledhur të dhëna socio-ekonomike apo të mjeteve të jetesës dhe po ashtu nuk parashikon masa për rivendosjen e mjeteve të jetesës së personave të prekur, ndërsa kjo është e parashikuar si kërkesë sipas KP 5/SMS 5.
- **Mbështetja për grupet e cenueshme:** Në legjislacionin e Kosovës nuk ekzistojnë dispozita specifike që ofrojnë mbështetje shtesë për grupet e cenueshme gjatë procesit të marrjes së tokës në pronësi (ndonëse akte të tjera legjislative mbrojnë të drejtat e grupeve të cenueshme).
- **Mekanizmi i ankesave që lidhen me projektin:** Legjislacioni i Kosovës nuk kërkon themelimin e një mekanizmi të ankesave që lidhen me projektin për të trajtuar shqetësimet e personave të prekur, gjë që kërkohet sipas KP 5/SMS 5.

- **Monitorimi dhe vlerësimi:** Në Kosovë, nuk ekziston asnjë kërkesë ligjore për të kryer monitorimin dhe vlerësimin e procesit të marrjes së tokës në pronësi dhe procesit të zhvendosjes, për dallim nga standardet e përvijuara në KP 5/SMS 5.

Të gjitha projektet që financohen nga BERZH dhe/ose KfW duhet të përmbushin kërkesat e KP 5/SMS 5 sipas BB. Për këtë arsye, është përgatitur ky dokument PMTRJ/KMTRJ për të trajtuar këto mangësi dhe për të mundësuar pajtueshmërinë e procesit të marrjes së tokës në pronësi me këto kërkesa.

Një pasqyrë më e detajuar e mangësive ndërmjet kërkesave sipas BERZH kundrejt kornizës ligjore të Kosovës, si dhe masat për plotësimin e këtyre mangësive, është dhënë te *Shtojcat*.

4. KOMPONENTI 1 – LOKALITETI I IMPIANTIT TERMIK DIELLOR

4.1. LOKACIONI

Impianti termik diellor planifikohet të ndërtohet në pjesën verilindore të Komunës së Obiliqit, duke u kufizuar në lindje me Komunën e Prishtinës. Lokaliteti i përcaktuar për ndërtim është një terren fushor dhe kodrinor, siç është paraqitur në figurat më poshtë. Aktualisht, kjo zonë është e mbuluar kryesisht me shkurre dhe të mbjella bujqësore. Lokaliteti përbëhet gjithsej nga katër parcela toke, të gjitha të regjistruara në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të drejta shfrytëzimi të dhëna Termokos-it.

Vendndodhja e Komponentës 1 është treguar në Figurën Figura 1.1:



Figura 4.1: Lokaliteti i impiantit termik diellor (burimi: Enova)

Shënim: Në kufirin perëndimor të lokalitetit të projektit, ndodhen dhjetë varre që i përkasin familjeve lokale. Për të trajtuar këtë çështje të ndjeshme, varret do të zhvendosen në një lokacion adekuat ose do të ruhen në lokacionin aktual përmes ndërtimit të një rrethoje mbrojtëse përreth tyre. Vendimi përfundimtar lidhur me qasjen që do të ndiqet do të merret në bashkërendim me familjet përkatëse, duke respektuar plotësisht preferencat e tyre kulturore, fetare dhe personale. Për të drejtuar këtë proces, do të përgatitet një Plan i Menaxhimit të Varreve, i cili do të sigurojë që të gjitha veprimet të realizohen në përputhje me legjislacionin kombëtar, normat kulturore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

4.2. IDENTIFIKIMI I SHFRYTËZUESVE TË LOKALITETIT TË IMPIANTIT TERMIK DIELLOR

Për të identifikuar saktësisht shfrytëzuesit e lokalitetit të përcaktuar për impiantin termik diellor, është realizuar një analizë e të dhënave kadastrale të siguruar nga komunat e Prishtinës dhe Obiliqit, e ndjekur nga vizitat në terren në lokacionin e projektit gjatë muajve korrik dhe gusht 2024. Megjithatë, duke qenë se gjatë kësaj periudhe nuk po zhvilloheshin aktivitete të gjera bujqësore, u ndërморën përpjekje shtesë për të vendosur komunikim me shfrytëzuesit e tokës gjatë muajve shtator dhe tetor 2024. Specialistët e zhvendosjes kanë bërë përpjekje të bashkërenduara për të verifikuar të gjithë shfrytëzuesit e tokës përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me banorët lokalë, si dhe me Termokos-in. Këto ndërveprime konfirmuan se parcelat e tokës po shfrytëzoheshin në mënyrë joformale nga tri familje⁶ për aktivitete të rregullta bujqësore. Pas identifikimit të shfrytëzuesve të tokës, nga fundi i muajit tetor 2024 u krye një anketë socio-ekonomike.

⁶ Në prill 2024, Termokos-i kishte marrë pëlqimin me shkrim nga njëri prej shfrytëzuesve joformalë të tokës për të kryer hetime gjeoteknike në lokalitet. Ky pëlqim u përcoll te specialistët e zhvendosjes për identifikimin e mëtejshëm të këtij shfrytëzuesi, i cili, gjatë diskutimeve, ndihmoi edhe në identifikimin e dy shfrytëzuesve të tjerë.

Objektivat kryesore të anketës socio-ekonomike ishin:

- Të krijohet një profil socio-ekonomik i detajuar i shfrytëzuesve joformalë;
- Të identifikohen burimet e të ardhurave të familjeve që mund të preken nga projekti dhe të vlerësohet rëndësia e tyre për mirëqenien e përgjithshme të ekonomive familjare;
- Të identifikohen faktorët e veçantë që ndikojnë në cënueshmërinë e këtyre ekonomive familjare.

Pyetësi që u përdor për këto anketime është paraqitur te *Shtojca 3: Pyetësi socio-ekonomik*

Shënim: Të anketuarit u informuan se duhet të nënshkruajnë *Deklaratën e pëlqimit për përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale*⁷ (shembulli i formularit të pëlqimit në gjuhën angleze është paraqitur *Shtojca 4: Formulari i pëlqimit për të dhënat personale*).

Gjithashtu, të anketuarit u informuan edhe mbi përdorimin e të dhënave të tyre, duke theksuar se pëlqimi jepet në mënyrë vullnetare dhe mund të tërhiqet në çdo moment.

4.3. REZULTATET E ANKETËS SOCIO-EKONOMIKE

Pasi janë identifikuar tre shfrytëzues joformalë të tokës (së bashku me familjet e tyre), në vijim atyre do t'u referohemi si "Familja A", "Familja B" dhe "Familja C". Për Familjen A dhe Familjen B, përfaqësues të familjeve ishin kryefamiljarët, ndërsa për Familjen C, përfaqësimi u bë nga biri i kryefamiljarit. Të gjithë të anketuarit ishin meshkuj, pasi nuk pati gra të moshës madhore që ishin të gatshme apo në dispozicion për të marrë pjesë në anketë, përkundër kërkesave të përsëritura nga specialistët e zhvendosjes.

Shfrytëzimi i tokës dhe aktivitetet bujqësore

Familja A ka shfrytëzuar në mënyrë joformale për afërsisht 24 vjet tokën që tani është e destinuar për impiantin termik diellor. Ata filluan të kultivojnë rreth 7.8 hektarë të kësaj ngastre pasi e pastruan atë nga bimësia. Aktivitetet kryesore bujqësore përfshijnë prodhimin e grurit, misrit dhe barit për kullotje. Mesatarisht, kjo ekonomi familjare raporton prodhim vjetor prej 9 ton grurë, 18 ton misër dhe 5,000 kg sanë. Familja i ka vlerësuar këto aktivitete si "shumë të rëndësishme" për të ardhurat e ekonomisë familjare. Për të mbështetur aktivitetet e veta bujqësore, familja përdor makineri bujqësore, përfshirë traktorë dhe pajisje të tjera. Ata nuk përdorin sisteme ujitëse në këtë tokë. Përveç tokës së shfrytëzuar në mënyrë joformale, familja gjithashtu zotëron dhe shfrytëzon në mënyrë aktive toka bujqësore në Mazgit, Obiliq, për aktivitete të ngjashme bujqësore. Aty mbajnë 8 lopë, të cilat i përdorin si për nevoja personale, ashtu edhe për shitjen e produkteve blegtorale. Kulturat bujqësore të mbjella në tokën e shfrytëzuar në mënyrë joformale, e cila është e destinuar për impiantin, përdoren si për konsum personal, ashtu edhe për mbështetjen e aktiviteteve blegtorale. Familja ka përfituar subvencione bujqësore nga qeveria për katër vitet e fundit (2021–2024).

Familja B ka shfrytëzuar në mënyrë joformale një pjesë të kësaj toke për 24 vjet dhe ka zhvilluar aktivitetet e veta bujqësore në afërsisht 14.5 hektarë.⁸ Familja kultivon një shumëllojshmëri kulturash bujqësore për konsum personal dhe për shitje. Mesatarisht, ekonomia familjare raporton prodhim vjetor prej 45 ton grurë, 45 ton misër dhe 6 ton

⁷ Të dhënat personale të mbledhura përmes pyetësorit përfshijnë: emrin dhe mbiemrin, vitin e lindjes, gjininë, adresën e banimit, adresën elektronike, numrin e telefonit/fiks ose celular, përkatësinë kombëtare, nivelin e arsimimit dhe gjendjen shëndetësore. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 06/L-082), kategoritë e posaçme të të dhënave personale përfshijnë, ndër të tjera, të dhënat që zbulojnë prejardhjen etnike dhe gjendjen shëndetësore. Në përputhje me sa më sipër, ligji përcakton detyrimin që pëlqimi për përpunimin e këtyre të dhënave personale të jepet me shkrim dhe të nënshkruhet nga individit të cilit i përkasin të dhënat.

⁸ Familja gjithashtu shfrytëzon 1.5 hektarë tokë që gjendet ngjitur me, por jashtë lokalitetit të impiantit termik diellor.

luledielli. Familja i ka vlerësuar këto aktivitete si “shumë të rëndësishme” për të ardhurat e ekonomisë familjare, pasi të korrat përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Familja gjithashtu përdor pajisje bujqësore (përfshirë traktorë dhe makineri të tjera ndihmëse, duke përfshirë edhe makina korrëse), ndërsa nuk ka qasje në sisteme ujitëse. Përveç kësaj, familja shfrytëzon gjithashtu një parcelë tjetër toke publike afër lokalitetit të projektit, gjithashtu në mënyrë joformale. Familja gjithashtu zotëron tokë bujqësore në Mazgit, Obiliq, të cilën e shfrytëzon për aktivitete të ngjashme bujqësore dhe zotëron 30 lopë (si për nevojat vetjake, ashtu edhe për shitje). Familja ka përfituar subvencione bujqësore nga qeveria vitin e shkuar (2022–2023).

Familja C ka shfrytëzuar në mënyrë joformale rreth 3 hektarë të tokës në fjalë që nga viti 1999 (për 25 vjet). Familja ka raportuar kultivimin e grurit dhe misrit, me një mesatare vjetore prej 7.5 tonë për secilën kulturë. Për aktivitetet bujqësore, familja përdor traktorë dhe pajisje të tjera përcjellëse, por nuk përdor sisteme ujitëse. Familja varet nga kjo tokë për prodhimin e ushqimit, duke siguruar afërsisht 75% të konsumit të përgjithshëm ushqimor nga të korrat e veta, ndërsa nuk shet produktet bujqësore që i prodhon. Ekonomia familjare ka përfituar subvencione bujqësore nga qeveria. Familja zotëron gjithashtu 1 hektar tokë bujqësore në Lazarevë dhe gjithashtu ka në pronësi dhe zhvillon një biznes të vogël familjar të zdrukthëtarisë.

Përbërja demografike e ekonomive familjare

Ekonomia familjare e *Familjes A* përbëhet nga gjithsej 21 anëtarë, përkatesisht 11 meshkuj dhe 10 femra. Kjo ekonomi familjare ka një numër të madh të vartësve, përfshirë 7 të mitur të moshës 0–18 vjeç dhe 2 anëtarë të moshuar me sëmundje kronike. Përbërja e detajuar demografike është si më poshtë:

MOSHA	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
0-6 vjeç	0	1	1
7-18 vjeç	3	3	6
19-30 vjeç	4	1	5
31-65 vjeç	3	4	7
Mbi 65 vjeç	1	1	2
GJITHSEJ	11 meshkuj	10 femra	21 anëtarë të ekonomisë familjare

Ekonomia familjare e *Familjes B* përbëhet nga gjithsej 30 anëtarë, përkatesisht 16 meshkuj dhe 14 femra. Kjo ekonomi familjare gjithashtu ka një numër të madh vartësish, duke përfshirë 21 të mitur. Përbërja e detajuar demografike është si më poshtë:

MOSHA	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
0-6 vjeç	6	5	11
7-18 vjeç	6	4	10
19-30 vjeç	1	2	3
31-65 vjeç	3	3	6
Mbi 65 vjeç	/	/	/
GJITHSEJ	16 meshkuj	14 femra	30 anëtarë të ekonomisë familjare

Ekonomia familjare e *Familjes C* përbëhet nga gjithsej 7 anëtarë, prej të cilëve 3 janë të mitur dhe 2 janë persona të moshuar që kanë raportuar sëmundje kronike që kërkojnë kujdes të rregullt mjekësor. Përbërja e detajuar demografike është si më poshtë:

MOSHA	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
0-6 vjeç	/	1	1
7-18 vjeç	1	1	2
19-30 vjeç	1	/	1
31-65 vjeç	/	1	1
Mbi 65 vjeç	1	1	2
GJITHSEJ	3 meshkuj	4 femra	7 anëtarë të ekonomisë familjare

Niveli arsimor

Familja A (me 14 të rritur) ka një nivel relativisht të lartë të arsimimit, ku shumica e të rriturve (10 prej tyre) kanë të përfunduar së paku arsimin e mesëm. Dy anëtarë të familjes kanë përfunduar shkollën fillore, ndërsa dy të tjerë kanë përfunduar studimet universitare në nivelin e studimeve themelore.

Të gjithë anëtarët e rritur të *Familjes B* (9 persona) kanë të përfunduar arsimin e mesëm. Asnjë prej tyre nuk ka përfunduar studimet e arsimit të lartë, gjë që mund të kufizojë mundësitë e tyre për punësim.

Për sa i përket *Familjes C*, nga 5 anëtarë të rritur, dy nuk kanë kryer asnjë nivel të arsimit formal, ndërsa tre kanë përfunduar shkollën e mesme.

Punësimi dhe të ardhurat

Në *Familjen A*, janë të punësuar 9 anëtarë, 3 janë studentë universitarë dhe 2 janë pensionistë. Të ardhurat mujore të përgjithshme të ekonomisë familjare tejkalojnë shumën prej 1,000 eurosh, ndërsa burimet kryesore të të ardhurave janë bujqësia dhe punësimi. Ekonomia familjare deklaroi se të ardhurat janë relativisht të qëndrueshme dhe nuk ndryshojnë sipas stinëve, por janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat bazë, veçanërisht duke marrë parasysh madhësinë e familjes. Shpenzimet kryesore përfshijnë ushqimin, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe transportin.

Të gjithë anëtarët e rritur të *Familjes B* (9 persona) janë të papunë. Burimi kryesor i të ardhurave të kësaj familjeje është prodhimi bujqësor, ndërsa të ardhurat mujore të përgjithshme të ekonomisë familjare tejkalojnë shumën prej 1,000 eurosh. Familja deklaroi se këto të ardhura mbulojnë vetëm nevojat bazë, përfshirë kostot e lidhura me arsimin dhe kujdesin shëndetësor të të miturve. Shpenzimet kryesore për këtë ekonomi familjare janë ushqimi, arsimi, shërbimet komunale dhe transporti.

Familja C ka një anëtar të punësuar, një të papunë, një student dhe dy pensionistë. Të ardhurat mujore të ekonomisë familjare variojnë ndërmjet 500 dhe 650 euro, ku burimet kryesore përfshijnë pagat, pensionet dhe prodhimin bujqësor, me disa ndryshime sezonale të të ardhurave. Shpenzimet kryesore për këtë ekonomi familjare përfshijnë shpenzimet për ushqim, arsim dhe kujdes shëndetësor. Familja e konsideron gjendjen e saj financiare si të mjaftueshme vetëm për të mbuluar nevojat bazë.

Ndërgjegjësimi dhe komunikimi rreth projektit

Familja A deklaroi se është informuar për projektin në vitin 2021 dhe se informacioni i marrë ka qenë i qartë, gjithëpërfshirës dhe i dhënë me kohë. Familja shprehu preferencën që komunikimi i mëtejshëm lidhur me ecurinë e projektit të bëhet përmes thirrjeve telefonike, me qëllim që të jenë tërësisht të informuar.

Familja B mori dijeni për projektin përmes mediave lokale në vitin 2022 dhe shprehu pakënaqësi me informacionin e pranuar, duke e konsideruar të pamjaftueshëm dhe jo të qartë. Kjo familje do të preferonte që në të ardhmen të informohet më tej për projektin përmes thirrjeve telefonike dhe takimeve të drejtpërdrejta.

Familja C është në dijeni për projektin që nga viti 2021 falë raportimeve në media. Megjithatë, familja vlerëson se informacioni i marrë nuk ka adresuar në mënyrë të mjaftueshme ndikimet për shfrytëzuesit joformalë të tokës. Ata do të preferonin që informimi i mëtejshëm të bëhet përmes takimeve të drejtpërdrejta.

Perceptimi i projektit dhe preferencat përkatëse

Familja A e vlerëson projektin pozitivisht, por shpreh shqetësime lidhur me humbjen e qasjes në tokën bujqësore dhe ndikimin që kjo mund të ketë në jetesën e tyre. Ata theksuan se, në mungesë të qasjes në tokë, do të rrezikoheshin siguria e tyre ekonomike dhe financiare. Për këtë arsye, familja do të preferonte që kompensimi të bëhet përmes qasjes në tokë alternative, e cila do t'u mundësonte vazhdimin e aktiviteteve bujqësore. Në rast se toka alternative nuk është në dispozicion, familja do të vlerësonte ofrimin e mundësive për punësimin e anëtarëve të ekonomisë familjare si formë alternative të kompensimit, apo kompensimin monetar. Familja nuk ka plane të qarta për veprimet që do të ndërmerren nëse nuk ofrohet tokë alternative.

Familja B shprehu shqetësime lidhur me projektin, duke theksuar se do të preferonin që projekti të ishte lokalizuar gjetiu dhe shprehën drojë për humbjen potenciale të tokës bujqësore që aktualisht kontribuon në prodhimin ushqimor. Për më tepër, familja pret që kjo do të shkaktojë humbjen e mjeteve të jetesës dhe reduktimin e burimit të vetëm të të ardhurave. Forma e preferuar e kompensimit për këtë familje është qasja në tokë bujqësore alternative, që do t'u mundësonte vazhdimin e aktiviteteve të tyre bujqësore. Nëse mundësia e tokës alternative nuk është në dispozicion, ata do të preferonin mbështetje në sigurimin e punësimit për anëtarët e familjes, ndërsa si opsion të tretë do të konsideronin kompensimin monetar.

Familja C e sheh projektin si pozitiv, por shpreh shqetësim për humbjen e të ardhurave si pasojë e humbjes së tokës bujqësore. Forma e preferuar e kompensimit për këtë familje është sigurimi i tokës alternative ose kompensimi monetar. Në rast se toka nuk do të jetë më në dispozicion për kultivim, familja planifikon të vazhdojë aktivitetin në biznesin familjar të zdrukthëtarisë.

Vlerësimi i cenueshmërisë

Bazuar në të dhënat gjithëpërfshirëse socio-ekonomike që janë mbledhur, të tria ekonomitë familjare mund të klasifikohen si të cenueshme, për shkak të një kombinimi faktorësh të ndërlikuar që ndikojnë në stabilitetin e tyre ekonomik. Treguesit kryesorë të cenueshmërisë janë si më poshtë:

Familja A

- **Të ardhura të paqëndrueshme të ekonomisë familjare:** Gjendja financiare e familjes varet shumë nga prodhimi bujqësor dhe burime të të ardhurave joformale përveç punësimit të rregullt. Familja ka deklaruar se të ardhurat janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë – gjë që rëndohet më tej nga fakti se familja përbëhet nga 21 anëtarë.
- **Numri i madh i vartësve, duke përfshirë të mitur dhe të moshuar:** Rreth një e treta e anëtarëve të familjes janë të mitur që nuk kontribuojnë si krah pune, duke shkakuar shkallë të lartë të varësisë ekonomike. Kjo strukturë demografike rrit presionin mbi anëtarët që gjenerojnë të ardhura për të mbuluar nevoja bazë si ushqimi, arsimit dhe kujdesi shëndetësor. Prania e dy personave të moshuar në ekonominë familjare, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë dhe ndihmë mjekësore për shkak të sëmundjeve kronike, rrit barrën financiare dhe emocionale mbi familjen.

Familja B

- **Të ardhura të paqëndrueshme të ekonomisë familjare:** Familja varet ekskluzivisht nga prodhimi bujqësor, i cili është i ndjeshëm ndaj ndryshimeve sezonale dhe luhatjeve të tregut. Asnjë nga të rriturit nuk është i punësuar. Të ardhurat aktuale mbulojnë vetëm nevojat bazë.
- **Raporti i lartë i varësisë:** Për shkak se 70% e anëtarëve të ekonomisë familjare janë të mitur, familja përballet me barrë të madhe ekonomike.
- **Niveli arsimor dhe mundësitë e kufizuara për punësim:** Mungesa e arsimit të lartë te të rriturit e zvogëlon ndjeshëm mundësinë për të gjetur punësim alternativ.

Familja C

- **Kufizime në të ardhura:** Pavarësisht se kanë disa burime të të ardhurave, të ardhurat mujore të ekonomisë familjare janë modeste (501–650 euro), gjë që mund ta bëjë më të vështirë përbalimin e humbjes së aktiviteteve bujqësore nëse toka që shfrytëzohet ndikohet nga Projekti.
- **Numri i madh i vartësve, duke përfshirë të mitur dhe të moshuar:** Tre anëtarë të ekonomisë familjare janë të mitur që nuk kontribuojnë si krah pune, dhe dy të moshuar vuajnë nga sëmundje kronike që kërkojnë kujdes të rregullt mjekësor, duke kufizuar aftësinë e tyre për të punuar ose për të marrë pjesë në aktivitete bujqësore.

Kur merren parasysh së bashku, këta faktorë sugjerojnë se familjet përballen me risk të lartë të vështirësive financiare. Varësia nga aktivitetet e bazuara në tokë, të cilat rrezikohen nga zhvillimi i impiantit termik diellor, së bashku me numrin e madh të vartësve, i vendos këto familje në pozitë të vështirë. Pa mekanizma të mjaftueshëm mbështetës, aftësia e tyre për të ruajtur standardin aktual të jetesës mund të cenohet ndjeshëm.

4.4. PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË PRITSHME

Projekti pritet të ketë disa ndikime të ndjeshme në ekonomitë familjare të prekura:

- **Humbja e tokës bujqësore:** Të tria ekonomitë familjare kanë shfrytëzuar tokën bujqësore në mënyrë joformale për më shumë se dy dekada për kultivim të kulturave bujqësore. Humbja e kësaj toke do të ndikojë ndjeshëm në aftësinë e tyre për të vazhduar aktivitetet bujqësore, të cilat janë thelbësore si për mbijetesën ashtu edhe për gjenerimin e të ardhurave.
- **Statusi ekonomik:** Familja A dhe Familja B varen nga të ardhurat bujqësore. Natyra sezonale e bujqësisë krijon paqëndrueshmëri financiare, duke u rënduar nga numri i madh i anëtarëve të ekonomisë familjare që nuk janë ekonomikisht aktivë, si fëmijët dhe të moshuarit, të cilët duhet të mbahen nga një numër i kufizuar i anëtarëve që gjenerojnë të ardhura. Familja C, me sipërfaqe më të vogël të tokës, varet nga kjo tokë kryesisht për prodhim ushqimor, që përbën rreth 75% të konsumit total ushqimor të familjes. Kjo varësi e bën familjen veçanërisht të cenueshme ndaj humbjes së tokës.
- **Cenueshmëritë:** Të gjitha ekonomitë familjare kanë numër të konsiderueshëm të vartësve, përfshirë të mitur dhe persona të moshuar, duke rritur presionin financiar dhe të ofrimit të kujdesit. Familja A dhe Familja C gjithashtu përballen me sfida shtesë për shkak të problemeve kronike shëndetësore të disa anëtarëve brenda ekonomisë familjare.
- **Qasja e kufizuar në kompensim:** Si shfrytëzues joformalë të tokës, asnjëra nga këto ekonomi familjare nuk kualifikohet për kompensim sipas rregulloreve lokale, duke i lënë ato të varura nga masa zbutëse alternative që priten nga projekti.

4.5. MASAT ZBUTËSE

Kjo pjesë paraqet masat zbutëse të zhvilluara mbi bazën e gjetjeve të paraqitura më sipër. Të tria familjet kanë shprehur preferencë të fuqishme për zhvendosje në një tokë të ngjashme me atë aktuale, në mënyrë që të vazhdojnë aktivitetet e tyre bujqësore. Megjithatë, të anketuarit gjithashtu kanë deklaruar gatishmërinë për të pranuar kompensim monetar nëse nuk mund të gjendet një lokalitet zëvendësues i përshtatshëm.

Për të adresuar këto nevoja, **Termokos fillimisht do të angazhojë një ekspert të licencuar dhe të kualifikuar të bujqësisë**⁹ (në vijim: eksperti i bujqësisë apo eksperti) i cili do të mbështesë implementimin e dy opsioneve kryesore të kompensimit: ofrimin e qasjes në tokë bujqësore alternative (opsioni i preferuar¹⁰) ose kompensimin monetar. Qëllimi i këtyre masave është të sigurohet që ekonomitë familjare të mund të vazhdojnë aktivitetet bujqësore me ndërprerje minimale, duke adresuar njëkohësisht edhe cenueshmërinë e tyre socio-ekonomike.

Data e ndërprerjes për këto ekonomi familjare do të jetë data e njoftimit zyrtar nga Termokos-i lidhur me këtë afat, pas së cilës çdo mbjellje e re, zhvillim infrastrukture apo aktivitet i ngjashëm nuk do të merret më parasysh, me përjashtim të mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese dhe përdorimit të mbjelljeve tashmë ekzistuese.

⁹ Eksperti i bujqësisë do të duhet të përmbushë këto kualifikime: diplomë master në shkenca bujqësore ose në një fushë të ngjashme; së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale përkatëse në vlerësime dhe konsulenca bujqësore; të jetë i licencuar si ekspert gjyqësor për çështje bujqësore; dhe të ketë njohuri mbi praktikën dhe rregulloret bujqësore lokale.

¹⁰ Sipas Politikës së BERZH të vitit 2019, kur mjetet e jetesës së personave të zhvendosur janë të bazuara në tokë, personave të prekur duhet t'u ofrohet kompensim i bazuar në tokë, përveç rasteve kur kjo është e pazbatueshme ose e papranueshme për ta. Prandaj, ofrimi i qasjes në tokë alternative përbën opsionin e preferuar për këtë projekt. Megjithatë, ky opsion mund të paraqesë sfida ligjore dhe praktike që mund të ndërlikojnë implementimin krahasuar me kompensimin monetar (p.sh., çështje të ndërlidhura me disponueshmërinë e tokës, përshtatshmërinë për përdorim bujqësor, kompleksitetet ligjore lidhur me marrëveshjet e qirasë). Nëse në fund të procesit konstatohet se zëvendësimi me tokë është i pazbatueshëm, një përfundim i tillë do të arsyetohet dhe dokumentohet në mënyrë të detajuar nga eksperti i bujqësisë.

Opsioni 1: Ofrimi i qasjes në tokë bujqësore alternative (opsioni i preferuar)

Objekti: Të sigurohet që ekonomitë familjare të prekura të kenë qasje në tokë të re që për nga karakteristikat është sa më e ngjashme me tokën që aktualisht e shfrytëzojnë, duke mundësuar vazhdimësinë e praktikave të tyre bujqësore.

Hapat për implementimin e këtij opsioni:

	Hapi	Shpjegimi
1.	Vlerësimi i tokës aktuale	<p>Ekspteri i bujqësisë do të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të tokës aktuale, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përlllogaritjen e vlerës financiare të të gjitha të mbjellave që do të humbasin nëse nuk bëhet korrja (përfshirë të mbjellat e sezonit aktual dhe të ardhurat e pritshme nga korrjet e mëvonshme që ekonomitë familjare mund të humbasin gjatë periudhës së tranzicionit) • përcaktimin e vlerës së investimeve infrastrukturore në tokë • vlerësimin e llojeve të të mbjellave, cilësisë së dheut, qasjes rrugore etj., për të identifikuar kërkesat specifike të ekonomive familjare për tokë të re
2.	Identifikimi dhe vlerësimi i tokës zëvendësuese	<p>Termokos-i, me mbështetjen e ekspertit të bujqësisë, do të identifikojë tokën zëvendësuese që i përmbush kriteret e përzgjedhjes si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të jetë e barabartë ose më e madhe për nga madhësia dhe cilësia e dheut me tokën aktuale; • preferohet të jetë e vendosur brenda një rrezeje prej 2 km nga lokaliteti ekzistues, për të siguruar qasje të lehtë • të jetë e disponueshme përmes një marrëveshjeje të menaxhueshme të qirasë afatgjatë (për të garantuar sigurinë e shfrytëzimit për familjet), me shpenzimet e qirasë të mbuluara nga Termokos-i për të paktën tre vjet <p>Ekspteri do të vlerësojë parcelat e propozuara të tokës zëvendësuese për të konfirmuar përshtatshmërinë e tyre për përdorim bujqësor dhe për të siguruar se i plotësojnë nevojat bujqësore të ekonomive familjare, veçanërisht në aspektet e cilësisë së dheut, mundësive për qasje, furnizimit me ujë, qasjes dhe infrastrukturës tjetër përkatëse.</p>
3.	Konsultimet me ekonomitë familjare të prekura	<p>Termokos-i do të organizojë takime (individuale), me praninë e ekspertit të bujqësisë, me ekonomitë familjare të prekura për të paraqitur gjetjet nga vlerësimet e tokës aktuale dhe asaj zëvendësuese. Kushtet e marrëveshjes së qirasë për tokën zëvendësuese do të prezantohen, dhe ekonomitë familjare do të mbështeten nga Termokos-i për të marrë vendimin më të përshtatshëm.</p> <p>Nëse ekonomia familjare pajtohet të vazhdojë me opsionin e tokës zëvendësuese, do t'i jepen 15 ditë për të shqyrtuar propozimin. Pas pranimit, marrëveshja do të formalizohet me shkrim. Kjo marrëveshje do të përvijojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e kompensimit sipas përshkrimit në hapin 4 më poshtë.</p>

		<p>Gjithashtu, do të përcaktohen kushtet specifike për çdo shfrytëzim të mëtejshëm të tokës, të cilat do të varen nga afatet e planifikuara të implementimit të projektit nga Termokos-i. Në rastet kur shfrytëzimi i mëtejshëm i tokës është i mundshëm, mund të bëhen rregullime për të lejuar ekonomitë familjare të korrin të mbjellat ekzistuese. Përndryshe, do të ofrohet kompensim adekuat për çdo humbje të të mbjellave.</p> <p>Këto takime do të mbahen në shtëpitë e personave të prekur, me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes përfshirëse dhe për të siguruar që të dyja gjinitë – gratë dhe burrat – të kontribuojnë me mendimin e tyre. Si gratë ashtu edhe burrat do të konsultohen për preferencat e tyre për tokën zëvendësuese dhe kontributet e tyre do të dokumentohen dhe do të merren në konsideratë.</p>
4.	Ofrimi i kompensimit	<p>Ekonomive familjare do t'u ofrohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kompensim sipas kostos së zëvendësimit për të gjitha përmirësimet e bëra në tokën aktuale deri në datën e ndërprerjes, si dhe për çdo kulturë bujqësore të humbur (nëse nuk mund të korret); • qasje në tokë të re përmes një marrëveshjeje të qirasë afatgjatë, me mbulimin e shpenzimeve të qirasë për tre vitet e para nga ana e Termokosit • kompensim për çdo humbje të shkaktuar gjatë periudhës së tranzicionit, për shkak të pamundësisë për të rifilluar menjëherë aktivitetet bujqësore (eksperti i bujqësisë do të përcaktojë kohëzgjatjen e kësaj periudhe kalimtare).
5.	Ofrimi i asistencës shtesë	<p>Eksperti do të ofrojë këshilla të përshtatura bujqësore dhe udhëzime praktike për tranzicionin në tokën e re. Këto udhëzime do të përfshijnë rekomandime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedhjen e kulturave bujqësore: këshillim mbi kulturat e përshtatshme në bazë të kushteve të tokës së re • përgatitjen e tokës: sqarime lidhur me përgatitjet e nevojshme për tokën e re, si përmirësimi i cilësisë së dheut dhe pastrimi i tokës • teknikat për përmirësimin e rendimentit: ofrimi i strategjive për rritjen e produktivitetit, përfshirë praktikatat më të mira për mbjellje. <p>Familjeve do t'u ofrohet gjithashtu ndihmë për identifikimin e subvencioneve përkatëse të qeverisë (përtej atyre që tashmë mund t'i kenë marrë të tri ekonomitë familjare, nëse është e aplikueshme), granteve bujqësore ose programeve të ndihmës financiare që mund të plotësojnë të ardhurat e tyre.</p> <p>Familjeve do t'u ofrohet mbështetje ligjore për t'i ndihmuar ata të kuptojnë të drejtat e tyre në lidhje me shfrytëzimin e tokës dhe marrëveshjen e qirasë, duke u siguruar që ata janë plotësisht të informuar për opsionet dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Për më tepër, nëse familjet shprehin interesim, Termokos-i do të angazhohet që të ndihmojë ekonomitë familjare me anëtarë të papunë në identifikimin dhe qasjen në mundësi për aftësim profesional që ofrohen nga autoritetet përkatëse (p.sh., Agjencia e Punësimit e</p>

		<p>Kosovës e sapoformuar, e cila ka zyra komunale në secilën komunë). Këto programe mund të fokusohen në zhvillimin e aftësive të ndërlidhura me bujqësinë (si teknikat moderne të kultivimit bujqësor, etj.) apo aftësive të tjera profesionale, varësisht nga interesat individuale apo mundësitë e ofruara. Konkretisht, Termokos-i do të:</p> <ul style="list-style-type: none">• ofrojë asistencë në procesin e aplikimit duke dhënë udhëzime për dokumentacionin dhe afatet përkatëse (nëse është e nevojshme)• mbulojë plotësisht tarifën e pjesëmarrjes në një program të tillë për secilin person të papunë nga secila prej tri ekonomive familjare• sigurojë që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në këto programe• pasi impianti termik diellor të jetë funksional, Termokos-i do t'i informojë drejtpërdrejt ekonomitë familjare të prekura për çdo vend pune apo mundësi punësimi në impiant (shënim: është me rëndësi të theksohet se Termokos-i nuk mund të japë garanci apo të bëjë zotime lidhur me punësimin e ardhshëm). <p>Të gjitha masat shtesë, përfshirë ofrimin dhe pranimin e mbështetjes, do të dokumentohen. Kjo do të përfshijë evidenca të konsultimeve me familjet dhe detaje mbi mbështetjen e ofruar/realizuar.</p>
--	--	--

Opsioni 2: Kompensimi monetar

Objekti: Të ofrohet një alternativë financiare në rast se nuk është e realizueshme mundësia për sigurimin e tokës zëvendësuese.

Hapat për implementimin e këtij opsioni:

Hapi		Shpjegimi
1.	Vlerësimi i tokës aktuale dhe përcaktimi i shumës së kompensimit monetar	<p>Eksperti i bujqësisë do të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të tokës aktuale, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> përlllogaritjen e vlerës financiare të të gjitha të mbjellave që do të humbasin nëse nuk mund të bëhet korrja (përfshirë të mbjellat e sezonit aktual dhe të ardhurat e pritshme nga korrjet e mëvonshme që ekonomitë familjare mund të humbasin gjatë periudhës së tranzicionit). përcaktimin e vlerës së investimeve infrastrukturore në tokë. vlerësimin e kostove të nevojshme për të mundësuar që familjet të marrin me qira tokë të ngjashme në atë zonë (në shumën që mbulon të paktën tre vite qira), duke siguruar që kompensimi të reflektojë normat aktuale të tregut për tokën bujqësore në atë lokalitet.
2.	Konsultimet me ekonomitë familjare të prekura	<p>Termokos-i do të organizojë takime (individuale), me praninë e ekspertit të bujqësisë, me ekonomitë familjare të prekura për të paraqitur gjetjet nga vlerësimi i tokës aktuale. Do të shpjegohen kushtet për ofrimin e kompensimit. Do të nënshkruhen marrëveshje me shkrim, të cilat do të përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha format e kompensimit sipas përshkrimit në hapin 3 më poshtë. Gjithashtu, do të përcaktohen kushtet specifike për çdo shfrytëzim të mëtejshëm të tokës, të cilat do të varen nga afatet e planifikuara të implementimit të projektit nga Termokos-i. Në rastet kur shfrytëzimi i mëtejshëm i tokës është i mundshëm, mund të bëhen rregullime për të lejuar ekonomitë familjare të korrin të mbjellat ekzistuese. Përndryshe, do të ofrohet kompensim adekuat për çdo humbje të të mbjellave.</p> <p>Këto takime do të mbahen në shtëpitë e personave të prekur, me qëllim të lehtësisë të pjesëmarrjes përfshirëse dhe për të siguruar që të dyja gjinitë – gratë dhe burrat – të kontribuojnë me mendimin e tyre. Si gratë ashtu edhe burrat do të konsultohen për preferencat e tyre për kompensimin monetar dhe kontributet e tyre do të dokumentohen dhe do të merren në konsideratë.</p>
3.	Ofrimi i kompensimit	<p>Ekonomitë familjare do t'u ofrohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> kompensim sipas kostos së zëvendësimit për të gjitha kulturat bujqësore të humbura dhe për përmirësimet e bëra në tokën ekzistuese. mjete monetare të mjaftueshme për të mbuluar kostot e qirasë për tokë bujqësore të ngjashme¹¹ për të paktën tre vjet. kompensim për çdo humbje të shkaktuar gjatë periudhës së tranzicionit, për shkak të pamundësisë për të rifilluar

¹¹ Termokos-i dhe shfrytëzuesit e prekur të tokës do të bien dakord për afatin kohor për gjetjen e parcelave alternative të tokës për të vazhduar aktivitetet bujqësore.

		<p>menjëherë këto aktivitete (eksperti i bujqësisë do të përcaktojë kohëzgjatjen e kësaj periudhe kalimtare).</p> <p>Shënim: Nëse një familje nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të vazhdojë me aktivitete bujqësore diku tjetër (p.sh., për shkak të mungesës së tokës së përshtatshme), ajo do të kompensohet për kulturat e humbura dhe për përmirësimet në tokën ekzistuese, si dhe do të marrë një pagesë të njëhershme të barasvlershme me totalin e të ardhurave të humbura që do të ishin gjeneruar nga toka aktuale gjatë një periudhe trevjeçare.</p>
4.	Ofrimi i asistencës shtesë	<p>Do të ofrohen udhëzime për mundësitë e reja për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore në rastet kur familjet marrin me qira një parcelë tjetër toke. Do të rekomandohen: llojet e përshtatshme të kulturave bujqësore, teknikat e produktivitetit dhe strategjitë për rritjen e të ardhurave në çdo tokë të re që vendosin ta kultivojnë.</p> <p>Familjeve do t'u ofrohet gjithashtu ndihmë për identifikimin e subvencioneve shtesë nga qeveria (përtej atyre që tashmë mund t'i kenë marrë të tri ekonomitë familjare, nëse është e aplikueshme), granteve bujqësore ose programeve të ndihmës financiare që mund të plotësojnë të ardhurat e tyre.</p> <p>Familjeve do t'u ofrohet mbështetje ligjore për t'i ndihmuar ata të kuptojnë të drejtat e tyre në lidhje me marrëveshjet e reja të qirasë, duke u siguruar që ata janë plotësisht të informuar për opsionet dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Për më tepër, nëse familjet shprehin interesim, Termokos-i do të angazhohet që të ndihmojë ekonomitë familjare me anëtarë të papunë në identifikimin dhe qasjen në mundësi për aftësim profesional që ofrohen nga autoritetet përkatëse (p.sh., Agjencia e Punësimit e Kosovës e sapoformuar, e cila ka zyra komunale në secilën komunë). Këto programe mund të fokusohen në zhvillimin e aftësive të ndërlidhura me bujqësinë (si teknikat moderne të kultivimit bujqësor, etj.) apo aftësive të tjera profesionale, varësisht nga interesat individuale apo mundësitë e ofruara. Konkretisht, Termokos-i do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ofrojë asistencë në procesin e aplikimit duke dhënë udhëzime për dokumentacionin dhe afatet përkatëse (nëse është e nevojshme) • mbulojë plotësisht tarifën e pjesëmarrjes në një program të tillë për secilin person të papunë nga secila prej tri ekonomive familjare • sigurojë që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në këto programe • pasi impianti termik diellor të jetë funksional, Termokos-i do t'i informojë drejtpërdrejt ekonomitë familjare të prekura për çdo vend pune apo mundësi punësimi në impiant (shënim: është me rëndësi të theksohet se Termokos-i nuk mund të japë garanci apo të bëjë zotime lidhur me punësimin e ardhshëm). <p>Të gjitha masat shtesë, përfshirë ofrimin dhe pranimin e mbështetjes, do të dokumentohen. Kjo do të përfshijë evidenca të konsultimeve me familjet dhe detaje mbi mbështetjen e ofruar/realizuar.</p>

4.6. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

Termokos-i do të krijojë një kornizë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi efektivitetin e masave zbutëse të përshkruara në seksionin e mësipërm. Një specialist i dedikuar për monitorim (preferohet me përvojë në fushën e bujqësisë) do të emërohet nga Termokos-i për të vlerësuar progresin e ekonomive familjare në drejtim të efektivitetit të masave mbështetëse.

Monitorimi dhe vlerësimi do të realizohen si gjatë procesit të transferimit në tokën e re ose përmes procesit të kompensimit monetar, ashtu edhe çdo vit gjatë një periudhe trevjeçare pas këtij transferimi, për të siguruar që mjetet e jetesës së ekonomive familjare të prekura të jenë tërësisht të rivendosura dhe të qëndrueshme.

Opsioni 1: Ofrimi i qasjes në tokë bujqësore alternative

Gjatë procesit të zëvendësimit të tokës, treguesit kryesorë që do të monitorohen janë:

- Numri i vizitave në lokalitet të realizuara nga specialisti i kualifikuar i bujqësisë (që do të angazhohet nga Termokos-i) për të vlerësuar tokën aktuale dhe atë zëvendësuese;
- Numri i konsultimeve të mbajtura me ekonomitë familjare për të mbledhur komente dhe preferenca;
- Qasja në tokën e re të ofruar sipas marrëveshjeve të qirasë afatgjatë (me mbulimin e kostos së qirasë për tre vitet e para nga ana e Termokos-it);
- Shuma dhe afatshmëria e disbursimit të fondeve të kompensimit për çdo humbje në tokën aktuale, përfshirë të mbjellat që nuk janë korrur dhe përmirësimet infrastrukturore, si dhe kompensimi për humbjet gjatë periudhës së tranzicionit;
- Dorëzimi i dokumentuar i asistencës shtesë (udhëzime të përshtatura enkas mbi tranzicionin bujqësor, mbështetje ligjore për të kuptuar të drejtat lidhur me shfrytëzimin e tokës dhe marrëveshjet e qirasë, identifikimi i programeve përkatëse qeveritare që mund të ndihmojnë në plotësimin e të ardhurave, mbështetje në identifikimin dhe qasjen në mundësi për aftësim profesional).

Pas zëvendësimit të tokës, treguesit kryesorë që do të monitorohen në përvjetorin e parë, të dytë dhe të tretë janë:

- Mbulimi i kostove të qirasë së tokës së re nga Termokos-i për së paku tre vjet;
- Produktiviteti bujqësor në tokën e re (numri i kulturave bujqësore të reja të mbjella me sukses në tokën zëvendësuese; përqindja e rritjes ose qëndrueshmërisë së rendimentit krahasuar me rendimentin bazë në tokën e mëparshme);
- Të ardhurat dhe qëndrueshmëria e ekonomisë familjare (ndryshimi në nivelin e të ardhurave; përqindja e të ardhurave të gjeneruara nga aktivitetet bujqësore në tokën e re);
- Kënaqshmëria dhe informacionet kthyes nga ekonomitë familjare (niveli i kënaqshmërisë me tokën e re përmes anketave/pyetësorëve; numri i shqetësimeve ose çështjeve të raportuara nga ekonomia familjare dhe sa prej tyre janë zgjidhur);
- Numri i subvencioneve apo granteve për të cilat ekonomia familjare ka aplikuar me sukses bazuar në udhëzimet e ekspertit të bujqësisë, përfshirë vlerësimin se si këto (nëse janë dhënë) kanë kontribuar në aftësinë e ekonomisë familjare për të mbajtur ose rritur produktivitetin e tyre bujqësor;
- Numri i individëve të papunë nga ekonomitë familjare të prekura që janë regjistruar dhe/ose kanë përfunduar me sukses programet e aftësimin profesional (të ndara sipas gjinisë)

Gjatë procesit të identifikimit, vlerësimit dhe transferimit të tokës, do të përpilohen raporte të rregullta të progresit çdo muaj, duke dokumentuar statusin e transferimit të tokës, informacionet kthyes nga ekonomitë familjare dhe çdo sfidë të hasur gjatë këtij procesi. Një raport përfundimtar gjithëpërfshirës do të përgatitet çdo vit për një periudhë trevjeçare pas zëvendësimit të tokës, duke përmbledhur efektivitetin e mbështetjes së ofruar dhe qëndrueshmërinë e mjeteve të jetesës së ekonomive familjare.

Opsioni 2: Kompensimi monetar

Gjatë procesit të kompensimit monetar, treguesit kryesorë që do të monitorohen janë:

- Numri i vizitave në lokalitet të realizuara nga specialisti i kualifikuar i bujqësisë (që do të angazhohet nga Termokos-i) për të vlerësuar tokën aktuale;
- Numri i konsultimeve të mbajtura me ekonomitë familjare për të mbledhur komente dhe preferenca;
- Shuma dhe afatshmëria e disbursimit të fondeve të kompensimit për ekonomitë familjare: kompensim për çdo humbje të pësuar në tokën aktuale, përfshirë të mbjellat që nuk janë korrur dhe përmirësimet infrastrukturore; mjete monetare të mjaftueshme për të mbuluar kostot e qirasë për tokë bujqësore të ngjashme për së paku tre vjet; pagesë e njëhershme e barasvlershme me totalin e të ardhurave të humbura që do të ishin gjeneruar nga toka aktuale gjatë një periudhe trevjeçare (në rast se familjet nuk janë në gjendje të vazhdojnë aktivitetet bujqësore diku tjetër); si dhe kompensim për çdo humbje të pësuar gjatë periudhës së tranzicionit (nëse familjet identifikojnë në mënyrë të pavarur tokë alternative për të vazhduar aktivitetet e tyre bujqësore);
- Dorëzimi i dokumentuar i asistencës shtesë (lidhur me mundësitë e ardhshme për aktivitete bujqësore nëse ekonomitë familjare vendosin të marrin me qira një parcelë tjetër toke; identifikimi i programeve përkatëse qeveritare që mund të ndihmojnë në plotësimin e të ardhurave, mbështetje në identifikimin dhe qasjen në mundësi për aftësim profesional).

Pas dhënies së kompensimit monetar, treguesit kryesorë që do të monitorohen në përvjetorin e parë, të dytë dhe të tretë janë:

- Përqindja e fondeve të kompensimit të investuara në aktivitete të reja bujqësore, qira të tokës, mundësi alternative të jetesës ose për qëllime të tjera;
- Të ardhurat dhe qëndrueshmëria e ekonomisë familjare (ndryshimi në nivelin e të ardhurave të ekonomisë familjare);
- Kënaqshmëria dhe informacionet kthyesë nga ekonomitë familjare (niveli i kënaqshmërisë me kompensimin e ofruar përmes anketave/pyetësorëve; numri i shqetësimeve ose çështjeve të raportuara nga ekonomia familjare dhe sa prej tyre janë zgjidhur);
- Numri i subvencioneve apo granteve, për të cilat ekonomia familjare ka aplikuar me sukses bazuar në udhëzimet e ekspertit të bujqësisë, përfshirë vlerësimin se si këto (nëse janë dhënë) kanë kontribuar në aftësinë e ekonomisë familjare për të mbajtur ose rritur produktivitetin e tyre bujqësor;
- Numri i individëve të papunë nga ekonomitë familjare të prekura që janë regjistruar dhe/ose kanë përfunduar me sukses programet e aftësimit profesional (të ndara sipas gjinisë).

Gjatë procesit të kompensimit monetar do të përpilohen raporte të rregullta të progresit çdo muaj, duke dokumentuar vlerësimin, disbursimin, informacionet kthyesë nga ekonomitë familjare dhe çdo sfidë të hasur gjatë këtij procesi. Një raport përfundimtar gjithëpërfshirës do të përgatitet çdo vit për një periudhë trevjeçare pas ofrimit të kompensimit, duke përmbledhur efektivitetin e mbështetjes së ofruar dhe qëndrueshmërinë e mjeteve të jetesës së ekonomive familjare.

4.7. ORARI TENTATIV I IMPLEMENTIMIT PËR KOMPONENTIN 1

Ky orar i implementimit përvijon aktivitetet kryesore dhe afatet kohore për komponentin 1 të projektit, duke siguruar që të gjitha detyrat e nevojshme të përmbushen në mënyrë efikase dhe brenda afatit të përcaktuar. Orari në tërësi përfshin përfundimin e të gjitha detyrave përpara çdo kufizimi në qasjen në tokë dhe para fillimit të punëve ndërtimore (me përjashtim të vlerësimit dhe raportimit përfundimtar).

AKTIVITETI	AFATI TENTATIV
Publikimi i PMTRJ për komponentin 1 në uebsajtin e Termokos-it dhe dërgimi i përmbledhjes jo-teknike të PMTRJ drejtpërdrejt te familjet e prekura	Të përcaktohet
Angazhimi i një eksperti të kualifikuar të bujqësisë dhe vlerësimi në lokalitet të tokës aktuale, përfshirë vlerësimin e detajuar të humbjeve dhe konsultimet me ekonomitë familjare të prekura ¹²	Të përcaktohet
Dërgimi i njoftimit zyrtar mbi datën e ndërprerjes për ekonomitë familjare të prekura	Të përcaktohet
Identifikimi i tokës zëvendësuese dhe konsultime shtesë me ekonomitë familjare të prekura për të diskutuar gjetjet	Të përcaktohet
Nënshkrimi i marrëveshjeve të qirasë për tokën zëvendësuese (nëse është e aplikueshme)	Të përcaktohet
Nënshkrimi i marrëveshjeve të kompensimit monetar (nëse është e aplikueshme)	Të përcaktohet
Vlerësimi dhe raportimi përfundimtar	1 vit pas dhënies së kompensimit

¹² Gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit, kur parashihet të zhvillohet ky vlerësim, misri zakonisht është korrur tashmë dhe kulturat dimërore të grurit janë në fazën e hershme të rritjes ose në fazë të fjetur. Prandaj, eksperti i bujqësisë do të fokusohet në vlerësimin e mbetjeve të mundshme të misrit, rritjes së hershme të kulturave dimërore të grurit (nëse ka), gjendjes së dheut dhe të dhënave historike mbi të lashtat për të vlerësuar humbjet potenciale. Konsultimet me ekonomitë familjare për të kuptuar rendimentet nga e kaluara dhe praktikat e tyre të mbjelljes do të jenë gjithashtu të dobishme. Kjo do të sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës përkundër sezonalitetit të këtyre kulturave bujqësore.)

5. KOMPONENTI 2 – TUBACIONET E BARTJES DHE LIDHJES

5.1. Rreth komponentës 2

Komponenta 2 përfshin dy rrugë tubacioni – Tubacionin A dhe Tubacionin B, të cilët janë projektuar për të lidhur vendin e centralit diellor termik dhe rezervuarin (Komponenti 1) me rrjetin e ngrohjes qendrore të Prishtinës (Komponenti 3):

- **Tubacioni A (rreth 4.6 km)** do të transportojë nxehtësinë nga centrali në qytet, duke përfunduar pranë Stadiumit të Prishtinës, ku lidhet me rrjetin ekzistues të ngrohjes qendrore.
- **Tubacioni B (rreth 1.48 km)** do të sjellë ujë të ngrohur paraprakisht nga rrjeti kryesor në centralin diellor përmes një pikë lidhjeje të re pranë Shkabajt.

Të dy tubacionet do të vendosen nën tokë dhe janë projektuar për të ndjekur rrugë të përshtatura në mënyrë optimale për të shmangur rrugët e ngarkuara, për të minimizuar ndërprerjet dhe për të përdorur korridoret ekzistuese të infrastrukturës aty ku është e mundur. Një tubacion shtesë do të ndërtohet gjithashtu për të transportuar një linjë uji për mbushjen e rezervuarit.

Ndryshime të vogla në trase mund të bëhen ende gjatë fazës së projektimit përfundimtar. Prandaj, kjo pjesë do t'i nënshtrohet përditësimeve pasi të konfirmohet përfundimisht traseja e tubacionit dhe të përfundojë Elaborati i hpronësimit.

Vendndodhja e Komponentës 2 është treguar në Figurën Figura 1.1: Harta e komponentëve të projektit të planifikuar.

5.2. Ndikimet e pritshme

[Ky është një identifikim paraprak i ndikimeve të mundshme, i cili do të përpunohet dhe konfirmohet më tej pas përfundimit të regjistrimit dhe anketës socio-ekonomike]

Servituti i përhershëm: Instalimi i tubacionit do të rezultojë në krijimin e përhershëm të një korridori servituti, i cili vendos kufizime specifike në përdorimin e tokës brenda dhe përreth trasesë së tubacionit. Këto kufizime janë thelbësore për të siguruar sigurinë afatgjate të operimit, qasjen për mirëmbajtje dhe integritetin fizik të infrastrukturës.

Gjatë gjithë gjatësisë së tubacionit do të përcaktohen dy zona të servitutit të përhershëm.

- **Korridori kryesor (gjerësia 6 metra rreth tubave):**

- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve apo strukturave permanente;
- Nuk lejohet gjërmim i thellë apo punime toke, që mund të dëmtojnë tubacionin;
- Zona duhet të mbetet pa gardhe, mure apo barriera fizike të tjera për të lejuar qasje të pakufizuar për mjetet e mirëmbajtjes dhe riparimet emergjente.

- **Korridori mbrojtës (shtesë 3 m, gjerësia totale 9 metra):**

- Ndalohet mbjellja e pemëve të mëdha ose me rrënjë të thella, pasi rrënjët e pemëve rrezikojnë integritetin e tubacionit;
- Bimësia me rritje të ulët dhe kulturat sezonale (p.sh. drithërat, perimet) lejohen.

Numri i saktë i pronave private, që do të ndikohen nga këto kufizime do të dihet pas përfundimit të Elaboratit të shpronësimit. Këto zona servituti do të jenë nën një leje të përhershme, duke i dhënë “Termokos”-it të drejta të plota për të instaluar, operuar dhe pasur qasje në infrastrukturë. Pronarët e tokës do të humbasin përgjithmonë të drejtën për të përdorur këto zona për qëllime, që bien ndesh me funksionin e tubacionit.

Këto kufizime mund të reduktojnë vlerën prodhuese të tokës ose të kufizojnë potencialin për zhvillim të ardhshëm. Këto ndikime do të vlerësohen individualisht për çdo parcelë të ndikuar gjatë procesit të vlerësimit.

“Termokos” do të kryejë monitorim të rregullt të korridorit të tubacionit për të siguruar përputhshmërinë me kufizimet e përdorimit të tokës dhe për të zbuluar kërcënime potenciale (p.sh., ndërtim i paautorizuar ose rritje pemësh). Monitorimi do të kryhet përmes vizitave vjetore ose gjysmëvjetore, në varësi të ndjeshmërisë dhe nivelit të rrezikut të çdo segmenti.

Korridori total i servitutit (rreth 9 metra gjerësi) do të regjistrohet në regjistrin zyrtar të tokës për të siguruar mbrojtje ligjore afatgjate të të drejtës së përdorimit për “Termokos”. Ky regjistrim do të krijojë të drejtat e servitutit në favor të “Termokos”-it dhe do të parandalojë konflikte të ardhshme në përdorimin e tokës. Të gjitha humbjet do të kompensohen (shih Matricën e të drejtave më poshtë).

Përdorimi i përkohshëm i tokës gjatë ndërtimit:

Gjatë ndërtimit, do të krijohet një korridor pune i përkohshëm me gjerësi 17 deri 20 m, aty ku hapësira e lejon. Ky korridor do të shërbejë për:

- Ruajtjen e dheut të gërmuar pranë kanalit;
- Pozicionimin paraprak të tubave para instalimit;
- Rrugët për qasje dhe hapësirat për kthesë për kamionë dhe makineri të rënda;
- Pajisje të specializuara për vendosjen e tubave, që janë ndjeshëm më të mëdha se pajisjet e përdorura për tubacionet e ujit.

Aty ku është e mundur (si në tokë bujqësore të hapur ose parcela të pazhvilluara), do të krijohen zona më të gjera për manipulim për të lehtësuar procesin e ndërtimit. Në këto raste do të përdoret e gjithë gjerësia 17–20 m. Përkundrazi, zonat urbane (p.sh., pjesa e shkallëve në Dragodan) kanë kufizime hapësinore. Këtu, gjerësia minimale e mundshme e manipulimit vlerësohet rreth 7.5 m, megjithëse kjo ndryshon në varësi të kushteve specifike të vendit (p.sh., gjerësia e rrugës, strukturat përreth, infrastruktura nën-tokësore).

Aktivitetet e ndërtimit do të organizohen në segmente, të përshtatura sipas dendësisë urbane përreth dhe hapësirës së disponueshme:

- Në zonat me popullsi të dendur ose të ndjeshme ndaj trafikut, segmentet zakonisht do të jenë 100–150 m për të minimizuar ndërprerjet dhe për të lehtësuar menaxhimin e trafikut;
- Në zonat më pak të zhvilluara ose bujqësore, mund të implementohen segmente më të gjata (deri në 500 m) ku gërmimi dhe instalimi janë më të thjeshta.

Çdo segment pritet të kërkojë rreth 2–4 javë për t’u përfunduar, megjithëse afatet mund të ndryshojnë për shkak të vonesave të paparashikuara, si për shembull takimi me infrastrukturë nën-tokësore të pa-evidentuara.

Përdorimi i përkohshëm i tokës mund të rezultojë në:

- Qasje të kufizuara në prona banimi dhe komerciale;
- Okupim ose dëmtim të përkohshëm të parcelave private pranë kanalit;

- Shqetësim të biznesit lokal, veçanërisht shitësit e vegjël rrugorë ose dyqane në zona të ngarkuara.

Për të lehtësuar këto ndikime:

- Qasja për këmbësorë dhe automjete do të mbahet në çdo kohë përmes instalimit të urave të përkohshme (për makina dhe këmbësor);
- Çdo hyrje e shtëpisë ose biznesit do të ketë një kalim të dedikuar dhe rrugë të sigurt;
- Pronat e dëmtuara (p.sh., gardhe, kultura, trotuare) do të kompensohen ose rikonstruktohen;
- Marrëveshje për përdorimin e përkohshëm të tokës do të bëhen me pronarët, ku është e nevojshme, duke specifikuar zonën, kohëzgjatjen, metodën e kompensimit dhe kushtet e rivendosjes (shih Matricën e të drejtave më poshtë);
- Të gjitha pronat do të rikthehen në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të ndërtimit, duke përfshirë rivendosjen e tokës sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dëmtuara (trotuare, bari, gardhe, etj.)

5.3. Metodologjia e regjistrimit dhe Anketës Socio- Ekonomike

Objektivat: Për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e huadhënësve dhe për të krijuar një bazë të saktë për planifikimin e zhvendosjes, do të kryhet një regjistrim dhe Anketë Socio-Ekonomike (ASE) gjithëpërfshirëse para fillimit të aktiviteteve të marrjes së tokës dhe zhvendosjes. Kjo do të shërbejë për identifikimin e personave të prekur, vlerësimin e ndikimeve dhe informimin mbi masat e kompensimit dhe rikthimit të mjeteve të jetesës.

Regjistrimi dhe ASE synojnë të identifikojnë të gjithë personat e prekur nga projekti (PPP), të krijojnë një bazë të karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike të PPP-ve, të identifikojnë individë ose grupe të cënueshme dhe të kuptojnë modelet ekzistuese të shfrytëzimit të tokës, pronësisë së aseteve, burimeve të të ardhurave dhe varësisë nga toka e prekur.

Përfshirja: Regjistrimi dhe ASE do të përfshijnë të gjithë pronarët, shfrytëzuesit dhe mbajtësit e tokës, asetet ose të ardhurat e të cilëve bien brenda hapësirës së përhershme ose të përkohshme të projektit, përfshirë:

- Zonat e caktuara për servitut të përhershëm;
- Tokat, që do të përdoren ose kufizohen përkohësisht gjatë ndërtimit.

Sa të jetë e mundur, synimi do të jetë të arrihet përfshirje e plotë (100%) e PPP-ve të prekur direkt.

Mjetet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave: Mbledhja e të dhënave do të bazohet në një kombinim të metodave sasiore dhe cilësore:

- Vëzhgimet në terren do të përdoren për të verifikuar llojet e aseteve dhe shfrytëzuesit e tokës direkt në vend, përfshirë praninë e shfrytëzuesve joformale, strukturave të përkohshme ose kulturave bujqësore;
- Rishikimi i të dhënave të Elaboratit të shpronësimit do të kryhet paralelisht për të konfirmuar pronësinë dhe statusin formal të tokës;
- Pyetësorë të strukturuar për familjet do të administrohen përmes intervistave ballë për ballë me kryefamiljarët ose anëtarët e rritur të familjes. Këta do të mbledhin të dhëna si:
 - Madhësia dhe përbërja e familjes;
 - Arsimi dhe shëndeti;
 - Punësimi dhe të ardhurat;
 - Pronësia dhe shfrytëzimi i tokës;
 - Qasje në infrastrukturë dhe shërbime;
 - Çështje të lidhura me projektin dhe preferenca për kompensim.

Pyetëtori për këto anketa është i përfshirë në **Shtojcën 3: Pyetëtori Socio-Ekonomik** (pyetësor i veçantë për familjet).

Shënim: Gjatë anketës rekomandohet që të jenë të pranishëm si anëtarët meshkuj ashtu edhe femra të familjes (p.sh., bashkëshorti dhe bashkëshortja), pasi pyetëtori kërkon përgjigje nga të dyja gjinitë.

- Pyetësorë të strukturuar për bizneset do të administrohen tek pronarët ose menaxherët e autorizuar të bizneseve formale dhe joformale, që ndodhen brenda ose pranë hapësirës së projektit. Këto anketa synojnë të vlerësojnë rreziqet potenciale të zhvendosjes ekonomike përkohshme ose të përhershme dhe do të mbledhin të dhëna për:
 - Llojin e aktivitetit të biznesit;
 - Statusin ligjor (i regjistruar/ i paregjistruar);
 - Numrin e punonjësve;
 - Të ardhurat mesatare dhe luhatjet sezonale;
 - Periudhat e pikut të biznesit;
 - Çështje të lidhura me projektin dhe preferenca për kompensim.

Pyetëtori për këto anketa është i përfshirë në **Shtojcën 3: Pyetëtori Socio-Ekonomik** (pyetësor i veçantë për bizneset).

Njoftimi paraprak: Para fillimit të regjistrimit dhe ASE, do të sigurohet njoftim paraprak për të gjitha komunitetet potencialisht të prekur përgjatë trasesë së tubacionit. Ky proces ka për qëllim të informojë komunitetet mbi qëllimin dhe fushën e aktiviteteve të ardhshme të anketës. Njoftimi do të publikohet në formë fletushkash një-faqëshe në vende të dukshme në çdo vendbanim. Njoftimet do të përfshijnë informacion mbi qëllimin e anketës, datat e planifikuara dhe kontaktet e ekipit të anketës për të mundësuar vizita pasuese në rast se personat e prekur nuk janë të pranishëm gjatë anketës fillestare.

Formulari i pëlqimit: Të gjitha aktivitetet e mbledhjes së të dhënave do të kryhen në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Respondentët do të informohen mbi nevojën për të nënshkruar një **Deklaratë të shkruar të pëlqimit për përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale** (shembulli i formularit në anglisht është i përfshirë në **Shtojcën 4: Formulari i pëlqimit për të dhëna personale**). Përveç kësaj, respondentët do të informohen mbi përdorimin e të dhënave të tyre, duke theksuar se pëlqimi jepet vullnetarisht dhe mund të tërhiqet në çdo moment.

Asnjë anketë nuk do të zhvillohet pa pëlqim të dokumentuar. Nëse pëlqimi refuzohet, intervista nuk do të kryhet dhe nuk do të regjistrohet asnjë informacion.

Trajnimi i anketuesve dhe sigurimi i cilësisë së të dhënave: Anketuesit do të trajnohen mbi objektivat e anketës, metodologjinë dhe procedurat për pëlqim të informuar dhe konfidencialitetin e të dhënave. Një specialist i zhvendosjes do të kryejë rishikime të rregullta të të dhënave të mbledhura për të siguruar saktësinë dhe plotësinë.

Rezultatet e regjistrimit dhe anketës socio-ekonomike do të shtohen në këtë PRMJ (pa informacion konfidencial) pasi të përfundojnë.

5.4. Matrica paraprake e të drejtave

[Ky është një identifikim paraprak i llojeve të humbjeve/ ndikimeve dhe të drejtave, i cili do të përpunohet dhe konfirmohet pas përfundimit të regjistrimit dhe ASE]

LLOJI I HUMBJES/NDIKIMIT POTENCIAL	TË DREJTAT
Humbje e përhershme e të drejtave të përdorimit për shkak të servitutit të tubacionit (korridor 9 m)	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensim me koston e plotë të zëvendësimit për humbjen e përhershme të të drejtave të përdorimit të tokës brenda korridorit të servitutit, bazuar në vlerën e tregut dhe zhvlerësimin e tokës për shkak të kufizimeve afatgjata mbi ndërtimin, mbjelljen dhe zhvillimin. • Kompensim monetar për humbjen ose dëmtimin e përmirësimeve të paluajshme brenda korridorit, si puse uji, sisteme ujitjeje, etj. • Kompensim për dëme aksidentale ose humbje të përkohshme gjatë instalimit ose mirëmbajtjes së tubacionit – të paguhet në vlerën e plotë të zëvendësimit. • Ndihmë për rikthimin e mjeteve të jetesës në rast se kufizimet e përdorimit të tokës ndikojnë në të ardhurat ose aktivitetet jetësore. Masa mund të përfshijë mbështetje për diversifikimin e kulturave, qasje në toka alternative, trajnim ose forma të tjera të mbështetjes për gjenerim të të ardhurave, bazuar në gjetjet e ASE. • Mbështetje për bizneset formale dhe joformale, që varen nga qasja publike (p.sh. shitës rrugorë, kioska), duke përfshirë ndihmë për zhvendosje, sigurimi i vendeve alternative për shitje, aty ku është e mundur, si dhe pagesa mbështetëse kalimtare në formë shumë fikse, të bazuar në të ardhurat mesatare ditore. Masa do të përshtatet sipas gjetjeve të ASE. • Ndihmë shtesë për familjet vulnerabël/cenuara në bazë të rastit (shih pjesën e fundit më poshtë në këtë tabelë).
Përdorimi i përkohshëm i tokës private për aktivitete ndërtimi	<ul style="list-style-type: none"> • Tokat dhe infrastruktura e prekur do të rikthehen në gjendjen para-projektit. • Kompensim monetar për përdorim të përkohshëm të tokës në masën e qirasë me çmimet e tregut. • Kompensim monetar për asetet e humbura (p.sh., struktura, pemë) për pronarin. • Kompensim për dëme ose humbje në vlerën e plotë të zëvendësimit ose me zëvendësim në natyrë ku është e mundur (p.sh., rimbjellje, rikonstruksion i gardhit). • Kompensim sipas vlerës së tregut për humbjen e të ardhurave neto nga kulturat që nuk mund të mbillen gjatë periudhës së posedimit të përkohshëm. <p>Shënim: Sipas kontratave midis kontraktorit dhe pronarëve të tokës, kontraktori do të krijojë një regjistër të detajuar para hyrjes në pronë për të dokumentuar gjendjen fillestare të pronës, që do të përdoret përkohësisht. Ky regjistër do të përfshijë fotografi, përshkrime dhe çdo dëshmi tjetër të rëndësishme për të përcaktuar qartë gjendjen fillestare. Pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve, do të përgatitet një raport për gjendjen përfundimtare, duke dokumentuar gjendjen e pronës pas përdorimit dhe duke e krahasuar me regjistrin fillestar për të vlerësuar ndryshimet ose dëmet. Bazuar në këtë, kontraktori do të jetë i detyruar të kompensojë për çdo dëm të shkaktuar dhe të rikthejë pronën në gjendjen e saj origjinale. Të gjitha përpjekjet për restaurim duhet të kryhen në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të minimizuar çdo shqetësim për pronarin. Procesi do të monitorohet nga “Termokos”.</p>
Qasje e kufizuar në shtëpi, biznese ose parcela bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhje përkohshme për qasje do të sigurohen në çdo kohë përmes instalimit të infrastrukturës së sigurt dhe funksionale, si ura këmbësore dhe për automjete, trotuare/kalime të përkohshme. • Njoftim paraprak dhe koordinim me familjet dhe pronarët e bizneseve të prekur për të planifikuar punimet e ndërtimit dhe për të minimizuar ndërprerjet ose për t'i caktuar ato në periudha kritike (p.sh. oraret e pikut të biznesit, periudhat e korrsjes). • Masat teknike të sigurisë për lëvizjen e sigurt të njerëzve, kafshëve dhe mallrave ku ndodhin punime. • Kompensim për humbje të dokumentuara të të ardhurave të pronarëve të bizneseve ose prodhuesve bujqësorë për shkak të kufizimeve të përkohshme të qasjes. • Mbështetje për bizneset formale dhe joformale që varen nga qasja publike, duke përfshirë ndihmë të përkohshme për zhvendosje dhe pagesa tranzitore sipas të ardhurave mesatare, bazuar në ASE

LLOJI I HUMBJES/NDIKIMIT POTENCIAL	TË DREJTAT
Ndikim disproportional/më i rëndë për shkak të vulnerabilitetit	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Matricë zbatohen në mënyrë të barabartë për familjet vulnerabël/cenuara;

5.5. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

“Termokos” do të monitorojë procesin e marrjes së tokës për të:

- konfirmuar nëse aktivitetet po zhvillohen sipas orarit dhe nëse afatet po respektohen;
- siguruar, që standardet e jetesës së personave të prekur të rikuperohen ose përmirësohen përmes monitorimit periodik ndaj indikatorëve të performancës dhe përshtatjes për përmirësim të vazhdueshëm në zbatim;
- vlerësuar nëse masat e kompensimit/rikuperimit janë të mjaftueshme;
- identifikuar metoda për të zbutur çdo problem të identifikuar.

“Termokos” do të mbajë një bazë të dhënash për marrjen e tokës, e cila do të përditësohet periodikisht.

Indikatorët që do të përdoren për monitorim do të përfshijnë, veçanërisht:

- Përqindjen e parcelave të regjistruara me servitut në regjistrin kadastral;
- Numrin e familjeve/bizneseve dhe aseteve të prekura;
- Shpenzimet totale për kompensim;
- Numrin e parcelave private të identifikuara nga kontraktori si të nevojshme për përdorim të përkohshëm gjatë punimeve të ndërtimit (lloji i parcelës, shuma e kompensimit të paguar, kohëzgjatja e përdorimit të tokës);
- Numrin e familjeve/personave vulnerabël dhe llojet e ndihmës të ofruara në kohë;
- Numrin e personave, që kanë marrë kompensim gjatë periudhës, sipas llojit dhe shumës së kompensimit;
- Numrin dhe shumën e pagesave dhe/ose programeve për rikthimin e mjeteve të jetesës;
- Numrin e rasteve me ankesa ose vonesa në pagesa;
- Numrin e aktiviteteve bujqësore të rikthyera me sukses pas marrjes së tokës ose kufizimit të qasjes si rezultat i projektit (rikthimi i nivelit të të ardhurave);
- Numrin e konsultimeve të mbajtura;
- Numrin dhe llojin e ankesave të dorëzuara përmes mekanizmit specifik të projektit, që lidhen me marrjen e tokës dhe përdorimin e përkohshëm të tokës;
- Numrin dhe llojin e çështjeve gjyqësore, që lidhen me marrjen e tokës dhe përdorimin e përkohshëm të tokës.

Rezultatet e monitorimit të brendshëm do të jenë pjesë e **Raportit Vjetor Mjedisor dhe Social** për huadhënësit. Pas përfundimit të aktiviteteve të PMTRJ, “Termokos” do të dorëzojë një **Raport Ekzekutiv për Marrjen e Tokës dhe Rikthimin e Jetës** te huadhënësit. Ky raport do të përfshijë:

- Përmbledhje të ndikimeve të projektit dhe parimeve, që udhëheqin PMTRJ-në;
- Përshkrim të përpjekjeve për të shmangur dhe minimizuar zhvendosjen;
- Përmbledhje të ngjarjeve të konsultimeve dhe rezultateve, duke përfshirë se si ato kanë ndikuar në të drejtat dhe karakteristikat e tjera të marrjes së tokës, zhvendosjes dhe aktiviteteve të rikthimit të mjeteve të jetesës;
- Përshkrim të procesit të dorëzimit të kompensimit;
- Përshkrim të çdo çështjeje të hasur dhe se si u zgjidhën;

- Përmbledhje të ankesave të pranuar dhe mënyrës se si u zgjidhën, duke përfshirë listën e ankesave dhe rasteve gjyqësore, që mbeten në pritje në datën e dorëzimit të raportit;
- Përshkrim të burimeve të mobilizuara për të planifikuar dhe zbatuar aktivitetet e marrjes së tokës, zhvendosjes dhe rikthimit të mjeteve të jetesës.

5.6. Orari tentativ i zbatimit për Komponentin 2

[Të shtohet pasi të jenë të disponueshme më shumë informacione]

6. KOMPONENTI 3 – RRJETI I NGROHJES QENDRORE DHE NËNSTACIONET

Ky komponent përfshin zgjerimin e rrjetit ekzistues të ngrohjes qendrore (DH) në Prishtinë për të furnizuar me ngrohje lagje shtesë. Qëllimi është të lidhen rreth 200 ndërtesa, duke përfshirë rreth 8,600 familje dhe 38,000 konsumatorë. Zonat për zgjerim u identifikuan përmes analizës teknike dhe ekonomike, duke u fokusuar në efikasitet dhe kosto-efektivitet në reduktimin e emetimeve të CO₂. Disa nga zonat e propozuara për zgjerim janë: “Lakrishte”, “Tophane”, “Kalabria”, “Dardha”, “Gjinaj jug”, “Prishtina e vjetër” dhe “Mahalla e Muhaxherëve”.

Çdo lidhje e ndërtesës kërkon koordinim me përfaqësuesit e ndërtesës, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave (p.sh., kërkesa për ngrohje), verifikimin e pengesave nën tokë dhe identifikimin e vendeve të përshtatshme për nënstacione.

Gjendja aktuale: Një vlerësim i detajuar në nivel ndërtese është në zhvillim. Deri më tani, 138 ndërtesa janë vlerësuar përmes vizitave në vend dhe komunikimit me personat kontaktues. Megjithatë, marrëveshjet formale me përfaqësuesit ligjorë ende nuk janë nënshkruar. Aktivitetet e vlerësimit pritet të jenë 90–95% të përfunduara deri në korrik.

Prandaj, ky seksion do të përditësohet me informacion të ri.

Vendndodhja e Komponentit 3 është e paraqitur në Figurën 1.1: Hartë e komponentëve të planifikuar të projektit.

7. ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT

Implementimit i PMTRJ/KMTRJ do të përfshijë aktivitete të synuara të angazhimit të palëve të interesit, me qëllim që PPP-të të jenë të informuar, të konsultuar dhe të kenë mundësi të marrin pjesë gjatë gjithë procesit. Një **përmbledhje jo-teknike dhe e përshtatshme për përdoruesin do t'u shpërndahet PPP-ve në fazat e hershme të procesit** (shih detajet më poshtë për secilin komponent). Kjo përmbledhje do të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të projektit, ndikimeve të mundshme, masave të planifikuara për zbutjen e tyre, si dhe të drejtave dhe të përfitimeve të PPP-ve. Përmbledhja do të shpërndahet përmes takimeve të drejtpërdrejta me PPP-të. **PMTRJ/KMTRJ i plotë do të publikohet në uebsajtin e Termokos-it dhe të gjitha përditësimet pasuese do të bëhen të disponueshme publikisht sapo të finalizohen.**

Aktivitetet e veçanta të angazhimit të palëve të interesit sipas secilit komponent janë përshkruar në detaje më poshtë:

Komponenti 1: Lokaliteti i impiantit termik diellor

Njoftimi mbi datën e ndërprerjes, publikimi i PMTRJ dhe shpërndarja e dokumentit përmbledhës jo-teknik mbi PMTRJ te familjet:

- Gjatë qershorit-korrikut 2025. 2025, Termokos-i do të nxjerrë një njoftim zyrtar për familjet e prekura në lidhje me datën e ndërprerjes, duke shpjeguar qartë qëllimin dhe pasojat e saj.
- Gjatë qershorit-korrikut 2025. 2025, Termokos-i do të publikojë PMTRJ-në për komponentin 1 në uebsajtin e vet dhe përmbledhja jo-teknike do t'u shpërndahet drejtpërdrejt familjeve të prekura.

Angazhimi i ekspertit të bujqësisë, vlerësimi i tokës dhe konsultimet në nivel të ekonomive familjare:

- Gjatë qershorit 2025, Termokos-i do të angazhojë një ekspert të kualifikuar të bujqësisë për të kryer një vlerësim të gjithanshëm të tokës aktuale dhe përshtatshmërisë së saj për aktivitete bujqësore. Do të mbahen takime individuale me secilën ekonomi familjare për të shqyrtuar gjetjet nga vlerësimi i tokës dhe opsionet për kompensim, duke siguruar që të gjithë anëtarët e ekonomive familjare, qofshin burra apo gra, të kenë mundësinë të japin mendimin e tyre. Termokos-i dhe eksperti i bujqësisë do të marrin pjesë së bashku në të gjitha takimet me ekonomitë familjare të prekura.
- Më pas, me mbështetjen e ekspertit të bujqësisë, Termokos-i do t'u paraqesë familjeve të prekura tokën zëvendësuese të identifikuar. Diskutimet do të përqendrohen në përshtatshmërinë e tokës zëvendësuese dhe kushtet e propozuara për qira. Familjeve do t'u jepet një afat prej 15 ditësh për të shqyrtuar propozimin. Në rastet kur preferohet kompensimi monetar, do të diskutohen gjithashtu kushtet dhe shumat përkatëse. Gjatë këtyre konsultimeve, Termokos-i do të shqyrtojë edhe masa shtesë mbështetëse, si udhëzime për mundësitë bujqësore, qasje në aftësim profesional dhe informacione për subvencione apo grante qeveritare.
- Termokos-i do të mbajë të dhëna të detajuara për të gjitha angazhimet, duke përfshirë evidencat e konsultimeve, marrëveshjet e nënshkruara dhe mbështetjen e ofruar.

Vlerësimi dhe raportimi përfundimtar:

- Një vit pas dhënies së kompensimit, Termokos-i do të zhvillojë konsultime pasuese me ekonomitë familjare të prekura për të vlerësuar efektivitetin e masave zbutëse. Informacionet kthyes nga PPP-të do të dokumentohen.

Komponenti 2: Tubacionet e bartjes dhe grumbullimit

Të përditësohet sapo të përfundojë studimi i shpronësimit.

Komponenti 3: Rrjeti i NQ dhe nënstacionet

Të përditësohet paralelisht me aktivitetet e komponentit 2.

8. MEKANIZMI I ANKESAVE

Mekanizmi i ankesave specifik për projektin është përshkruar në detaje në Planin e angazhimit të palëve të interesit dhe është përmbledhur këtu për qëllime të këtij dokumenti PMTRJ/KMTRJ.

NJIP do të ofrojë një mekanizëm ankesash, duke përfshirë edhe çdo ankesë që lidhet me këtë PMTRJ/KMTRJ. Ankesat mund t'i parashtrohen NJIP-së në mënyrë verbale (drejtpërdrejt ose përmes telefonit) apo me shkrim përmes Formularit për ankesa (shih *Shtojcën 2*), apo në ndonjë format tjetër të preferuar, përmes postës ose email-it në adresat e kontaktit të dhëna më poshtë, pa asnjë kosto për ankuesit. Ankesat mund të dorëzohen në mënyrë anonime. Pas fillimit të punimeve ndërtimore, ankesat mund të dorëzohen edhe drejtpërdrejt te kontraktuesit apo inxhinieri mbikëqyrës, të cilët do t'ia përcjellin menjëherë çdo ankesë NJIP-së brenda 24 orësh.

NJIP-ja do të evidentojë të gjitha ankesat në Regjistrin e Ankesave dhe do të konfirmojë marrjen e ankesës brenda 7 ditëve kalendarike.

Në vijim janë dhënë hapat që ndërmerren nga NJIP-ja për zgjidhjen e ankesave në nivelin e parë dhe të dytë:

1. **Zgjidhja e nivelit të parë:** Pasi të konfirmojë marrjen e ankesës me shkrim, NJIP-ja do të mbledhë informacione lidhur me ankesën. Pas analizimit të çështjes, NJIP-ja do të propozojë një zgjidhje dhe do të njoftojë ankuesin për hapat e rekomanduar korrigjues dhe veprimet pasuese brenda 14 ditëve kalendarike, përmes email-it ose postës së zakonshme.
2. **Zgjidhja e nivelit të dytë:** Nëse NJIP-ja nuk arrin të zgjidhë ankesën përmes veprimeve të menjëhershme korrigjuese, çështja do t'i dërgohet nivelit të radhës në procesin e zgjidhjes së ankesave, që është **Komisioni i NJIP-së**. Në këtë rast, NJIP-ja do të njoftojë ankuesin se ankesa e tij/saj i është referuar Komisionit të NJIP-së për shqyrtim të mëtejshëm.

Komisioni i NJIP-së do të përbëhet nga tre anëtarë: dy nga NJIP-ja dhe Termokos-i, dhe një vëzhgues nga komuna përkatëse (Prishtinë ose Obiliq, varësisht nga përmbajtja e ankesës). NJIP-ja do të ketë përgjegjësinë të informojë Komisionin për rezultatet e tentativave të para për zgjidhjen e ankesës, si dhe të prezantojë qëndrimet e të dyja palëve – ankuesit dhe NJIP-së.

Komisioni i NJIP-së do të mbajë takime me ankuesin dhe NJIP-në, duke siguruar që të gjitha procesverbalet e takimeve të dokumentohen siç duhet. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni do t'ia komunikojë vendimin e vet me shkrim ankuesit. Nëse ankuesi pajtohet me zgjidhjen e propozuar, ai/ajo duhet ta bëjë pranimin e zgjidhjes me shkrim. Nëse nuk pajtohet, ankuesi ka të drejtë të ndjekë më tej çështjen përmes rrugëve ligjore.

Komisioni i NJIP-së është përgjegjës për zgjidhjen e ankesës brenda 30 ditëve kalendarike nga konfirmimi i marrjes së saj. Në rast se nuk arrin të japë zgjidhje brenda këtij afati, Komisioni duhet të ofrojë një shpjegim të detajuar se përse çështja nuk mund të adresohet. Për më tepër, shpjegimi duhet të përfshijë udhëzime për mënyrën e veprimit nëse ankuesi mbetet i pakënaqur me rezultatin.

Në çdo kohë, ankuesit mund të kërkojnë mjete të tjera juridike, në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, përfshirë edhe ankimet formale në gjykatë.

Të dhënat e kontaktit për dërgimin e kërkesave për informim apo ankesave:

Ngrohtorja solare e Prishtinës

Termokos Sh.A. – Njësia e Implementimit të Projektit

Adresa: Rr. 28 Nëntori nr. 181, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni: + 383 038 541780

E-mail: info@termokos.org; solar4kosova@termokos.org

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektet e BERZH-it. Përveç mekanizmit të ankesave për projektin, që menaxhohet nga NJIP-ja, Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektet (IPAM) e BERZH-it,¹³ përbën një mjet të pavarur dhe të fundit për zgjidhjen e ankesave, që përdoret në rastet kur mekanizmi i projektit dështon. Qëllimi i këtij mekanizmi është: të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve që lidhen me ndikimet sociale, mjedisore dhe transparencën publike, të ngritura nga personat e prekur nga projekti ose nga organizatat e shoqërisë civile, në lidhje me projektet e financuara nga BERZH-i; të vlerësojë nëse Banka ka vepruar në përputhje me Politikën e saj për Mjedisin dhe Shoqërinë, si dhe me dispozitat specifike për projektin të përfshira në Politikën për Qasje në Informacion; dhe, kur është e aplikueshme, të adresojë çdo mospërputhje ekzistuese me këto politika dhe të ndihmojë në parandalimin e mospërputhjeve të mundshme në të ardhmen nga ana e Bankës.

¹³ Më shumë informacione rreth procesit të mekanizmit IPAM mund të gjenden këtu: <https://www.ebrd.com/what-we-do/independent-project-accountability-mechanism.html>

9. SHTOJCAT

Shtojca 1: Përmbledhje e mangësive ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe kërkesave të parashikuara sipas KP 5 BERZH / SMS 5 BB¹⁴

ÇËSHITJA	KËRKESAT SIPAS KP 5/SMS 5	DISPOZITA SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS	MASAT PËR TË TRAJTUAR MANGËSINË
Procesi i planifikimit	Kërkohet që klienti të kryejë një vlerësim socio-ekonomik bazë të PPP-ve, me qëllim të identifikimit të ndikimeve që dalin nga marrja e tokës në pronësi dhe kufizimet në shfrytëzimin e saj, si dhe të zhvillojë masa të përshtatshme për të minimizuar dhe zbutur ndikimet nga zhvendosja. Kërkohet gjithashtu hartimi dhe implementimi i planeve të detajuara për marrjen e tokës në pronësi.	Kërkohet vetëm realizimi i një studimitë shpronësimit si regjistrim bazë; nuk ka asnjë kërkesë të dhënë shprehimisht për kryerjen e anketave socio-ekonomike apo hartimin e planeve për marrjen e tokës në pronësi dhe zhvendosje.	Për të trajtuar këtë mangësi, përgatitja e këtij dokumenti të përditësuar të PMTRJ-së (duke iu referuar komponentëve 1 dhe 2) përfshin kryerjen e anketës socio-ekonomike dhe regjistrimit, me qëllim të identifikimit të shfrytëzuesve formalë dhe joformalë të tokës/pronës, si dhe të personave/ekonomive familjare në situatë të cenueshme dhe mjeteve të jetesës së të gjithë PPP-ve.
Data e ndërprerjes	Kërkohet që klienti të caktojë një datë të ndërprerjes për përcaktimin e së drejtës për përfitime dhe që kjo datë të komunikohet në të gjithë zonën e projektit.	Parashikon që kompensimi të mos paguhet për koston ose vlerën e përmirësimeve në pronë pas datës në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm të procesit të shpronësimit është botuar në Gazetën Zyrtare, ose për çdo ndryshim në vlerën e tregut të pronës, qoftë pas datës së miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore ose pas datës së dorëzimit të parë të kërkesës për shpronësim - cilado ndodh më herët.	Datat e ndërprerjes të përcaktuara në legjislacionin kombëtar do të përdoren për pronarët/shfrytëzuesit formalë. Për shfrytëzuesit joformalë, datë e ndërprerjes do të jetë data e përfundimit të regjistrimit dhe inventarizimit të pasurive. Për komponentin 1, datë e ndërprerjes për shfrytëzuesit joformalë do të jetë data e njoftimit zyrtar nga Termokos-i mbi datën e ndërprerjes. Personat e prekur do të informohen me kohë për datat e ndërprerjes.
Ujditë e negociuara	Nga klientët pritet të kërkojnë pronë përmes ujdive të negociuara me kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm, edhe nëse kanë mjetet ligjore për të fituar qasje në tokë përmes procedurës së shpronësimit.	Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme nuk i ndalon ujditë e negociuara, por as nuk i kërkon ato si të detyrueshme.	Termokos-i do të bëjë çdo përpjekje për të arritur ujdë të negociuara me PPP-të (veçanërisht për komponentët 2 dhe 3) për të shmangur shpronësimin. Këto përpjekje do të dokumentohen. Mundësitë për ujdë të negociuara do të ndiqen kurdo që të jetë e mundur përpara fillimit të procesit të shpronësimit.

¹⁴ KfW aplikon SMS 5 të Bankës Botërore në projektet e saj.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS KP 5/SMS 5	DISPOZITA SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS	MASAT PËR TË TRAJTUAR MANGËSINË
<p>Vlera dhe koha e kompensimit</p>	<p>Kompensimi për pasuritë e humbura duhet të ofrohet me kosto zëvendësimi të plotë dhe ofrohet përpara se personi/personat e prekur të pësojnë humbjen.</p>	<p>Kompensimi bazohet në vlerën e tregut të pronës. Nuk lejohet qasja në pronë nga autoriteti shpronësues pa pagesën e kompensimit për pronarët e prekur.</p>	<p>Kompensimi do të ofrohet në përputhje me kërkesat e BERZH-it dhe para çdo hyrjeje në tokë. Të drejtat specifike shpjegohen në seksionet përkatëse të këtij dokumenti.</p> <p>Për të zgjidhur çështjen e pagesës së kompensimit sipas vlerës së zëvendësimit, Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave do të njoftohet për kërkesat e përvijuara në këtë PMTRJ (kompensimi sipas kostonë së zëvendësimit) pasi të kryhet Studimi i Shpronësimit nga Termokos-i. Termokos-i do të garantojë që vlerësimi i pronës në secilin rast individual t’i mundësojë PPP-ve të marrin në pronësi tokë zëvendësuese (p.sh., parcela të tokës bujqësore) në zonat në afërsi. Kjo përfshin mbulimin e çdo kostoje shtesë, si tarifata e noterit për blerjen e pronës së re, shpenzimet që lidhen me transferimin e titullit pronësor dhe shpenzimet që lidhen me lidhjet e shërbimeve komunale (p.sh., sistemet e ujitjes) dhe shpenzimet për zhvendosje.</p>
<p>E drejta për kompensim</p>	<p>Personat e prekur nga projekti për sa i përket KP 5 BERZH/BB mund të klasifikohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Personat që kanë të drejta ligjore formale mbi tokën (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve të vendit) – <i>gëzojnë të drejtë kompensimi për humbjen e pasurive sipas kostonë së zëvendësimit të tyre</i> b) Personat që nuk kanë të drejta ligjore formale mbi tokën në kohën e regjistrimit, por që kanë pretendime për tokën që janë të njohura ose njihen sipas ligjeve të vendit – <i>gëzojnë të drejtë kompensimi për humbjen e pasurive sipas kostonë së zëvendësimit të tyre</i> 	<p>Vetëm personat me të drejta dhe pretendime që njihen ligjërisht mund të marrin kompensim.</p>	<p>E drejta për kompensim dhe rivendosje të mjeteve të jetesës do t’u shtrihet edhe personave të prekur që nuk kanë të drejta apo pretendime që njihen ligjërisht mbi tokën që e shfrytëzojnë për jetesë (e mundësuar ligjërisht përmes Ligjit nr. 08/L-222 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZH-it; si dhe Dekreteve nr. 11/2023 dhe 13/2023 për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe KfW-së për Projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”). Për komponentin 1, Termokos-i do të angazhojë një ekspert të kualifikuar të bujqësisë për të kryer vlerësimin në lokalitet</p>

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS KP 5/SMS 5	DISPOZITA SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS	MASAT PËR TË TRAJTUAR MANGËSINË
	<p>c) Personat që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore ose pretendim të njohur për tokën që shfrytëzojnë – gëzojnë të drejtën për strehim (banim) adekuat me siguri posedimi nëse zhvendosen fizikisht dhe/ose kompensim për çdo humbje në atë tokë (kultura bujqësore, infrastrukturë në tokë, etj.) nëse zhvendosen ekonomikisht</p>		<p>të tokës ekzistuese dhe për të identifikuar tokë zëvendësuese, duke përfshirë edhe vlerësimin e detajuar të humbjeve si dhe ofrimin e mbështetjes gjatë konsultimeve me ekonomitë familjare të prekura.</p> <p>Të drejtat specifike shpjegohen në seksionet përkatëse të këtij dokumenti.</p>
<p>Grupet e cënueshme</p>	<p>KP 5 BERZH kërkon që grupet e cënueshme të identifikohen gjatë kohës së realizimit të anketave socio-ekonomike, si dhe të konsultohen dhe të mbështeten me masa ndihmëse të përshtatura sipas nevojave të tyre.</p>	<p>Nuk ka dispozita specifike në <i>Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme</i>. Megjithatë, ndihma dhe mbrojtja e grupeve “në rrezik” ofrohet, në një masë të caktuar, në bazë të ligjeve të veçanta që rregullojnë të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat pronësore (siç është <i>Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit</i>, i cili ofron mundësi strehimi për grupet e cënueshme; ligje të tjera që rregullojnë skemat sociale, punësimin, barazinë gjinore, përdorimin e gjuhëve, mosdiskriminimin, etj.)</p>	<p>Grupet e cënueshme do të identifikohen përmes anketave socio-ekonomike që do të realizohen për komponentin 1 dhe komponentin 2. Masat përkatëse do të aplikohen në përputhje me kërkesat e këtij PMTRJ gjatë procesit të marrjes së tokës në pronësi.</p> <p>Sipas nevojës, do të konsultohet dhe do të angazhohen autoritetet përkatëse përgjegjëse për mirëqenien sociale (siç janë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Skemave Sociale dhe Departamenti i Pensioneve, Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Mirëqenies Sociale, dhe Komuna e Obiliqit – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale).</p> <p>Në rast se identifikohen grupe të pakicave etnike, të gjitha komunikimet dhe dokumentacioni që u dorëzohen atyre si pjesë e procesit të konsultimit, duhet të realizohen në një gjuhë të përshtatshme, e cila njihet si gjuhë zyrtare ose në përdorim zyrtar në nivel komunal në Kosovë.</p>
<p>Mekanizmi i ankesave</p>	<p>Një mekanizëm i ankesave në nivel të projektit duhet të vendoset sa më herët në proces, për të</p>	<p>Pronarët ose mbajtësit e interesit kanë të drejtë të paraqesin ankesa në faza të</p>	<p>Një procedurë ankimi e dedikuar për projektin është pjesë e implementimit të Planit të</p>

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS KP 5/SMS 5	DISPOZITA SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS	MASAT PËR TË TRAJTUAR MANGËSINË
	<p>pranuar dhe trajtuar me kohë shqetësimet e veçanta lidhur me kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga PPP-të.</p>	<p>ndryshme të procesit dhe të dorëzojnë komente me shkrim tek autoriteti shpronësues gjatë procesit të konsultimeve, mirëpo nuk ekziston asnjë kërkesë për mekanizëm të ankesave në nivel të projektit.</p>	<p>angazhimit të palëve të interesit (PAPI) dhe do të përfshijë edhe aspektet që kanë të bëjnë me marrjen e tokës në pronësi.</p>
<p>Pjesëmarrja/ konsultimet domethënëse</p>	<p>Klienti do të organizojë konsultime domethënëse me personat dhe komunitetet e prekura përgjatë gjithë procesit të planifikimit dhe implementimit të zhvendosjes.</p> <p>Përpjekjet për konsultim dhe angazhim duhet të mbështeten me dokumentacion të thjeshtë, praktik, të saktë dhe të përshtatshëm nga aspekti kulturor, të destinuar për shpërndarje të gjerë të personat e prekur.</p>	<p>Disa nene të <i>Ligjit për shpronësimin e pronave të paluajtshme</i> parashikojnë njoftimin/konsultimin me pronarët e pronave, por vetëm për pronarët formalë të tokave.</p>	<p>Ky PMTRJ/KMTRJ përfshin kërkesa për dhënie të informacioneve shpjeguese dhe konsultime në përputhje me kërkesat e KP 5.</p>
<p>Monitorimi i implementimit të zhvendosjes</p>	<p>Rregullimet për monitorimin e procesit të marrjes së tokës në pronësi duhet të përkufizohen me planin e zhvendosjes.</p>	<p>Nuk ka dispozitë</p>	<p>Monitorimi do të kryhet nga NJIP-ja, siç përcaktohet në këtë PMTRJ/KMTRJ.</p>

Shtojca 2: Formulari për ankesa

Numri i referencës (të plotësohet nga NJIP-ja)	
Emri dhe mbiemri (opsionale) <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëshiroj të paraqes ankesën time në mënyrë anonime. ▪ Kërkoj që identiteti im të mos zbulohet pa pëlqimin tim. 	
Informacionet e kontaktit Ju lutemi shënoni mënyrën si dëshironi t'ju kontaktojmë (me postë, me telefon, me email).	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Me postë: <i>Ju lutemi jepni adresën postare:</i> _____ ▪ Me telefon: _____ ▪ Me e-mail: _____
Gjuha e preferuar e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqip ▪ Serbisht ▪ Tjetër: _____
Përshkrimi i incidentit për të cilin ankoheni	Çfarë ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Kujt i ka ndodhur? Cilat janë pasojat e problemit?
Data e incidentit / ankesës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Incident/ankesë që ka ndodhur vetëm një herë (data ____) ▪ Incident/ankesë që ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? ____) ▪ Incident/ankesë e vazhdueshme (aktualisht jeni duke u ballafaquar me problemin)
Çfarë prisni të ndërmerret për këtë ankesë?	
<p>Informacionet e kontaktit për pyetje dhe ankesa: Lënda: Solar 4 Kosovo II Vëmendje: Termokos Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës solar4kosova@termokos.org Telefoni: +383 38 541780, lokali 13 ose 19</p>	
Nënshkrimi: _____ Data: _____	

Shtojca 3: Pyetësi socio-ekonomik**PYETËSOR PËR SHFRYTËZUESIT JOFORMALË TË LOKALITETIT TË PLANIFIKUAR PËR IMPIANTIN TERMIC DIELLOR NË PRISHTINË**

Numri referues i pyetësit:	
Data e anketimit:	
Emri dhe mbiemri i anketuesit:	

1. KARAKTERISTIKAT/ TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË EKONOMISË FAMILJARE

Emri dhe mbiemri i të anketuarit:	
A është i anketuari kryefamiljar:	
<i>Nëse përgjigja është "jo" më sipër, emri dhe mbiemri i kryefamiljarit:</i>	
Gjinia e kryefamiljarit:	
Mosha e kryefamiljarit:	
Statusi martesor i kryefamiljarit:	
Gjinia e të anketuarit – nëse ai/ajo nuk është kryefamiljari)	
Përkatësia etnike:	
Numri i telefonit për kontakt:	
Statusi i punësimit të kryefamiljarit:	
Ku jeton ekonomia familjare? (vendbanimi dhe distanca nga impianti termik diellor i planifikuar)	
Sa kohë ka që familja jeton aty?	

Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare (mosha dhe gjinia)

	Mashkull	Femër	Marrëdhënia me kryefamiljarin	Gjithsej
0-6 vjeç			Vajza / mbesa	
7-18 vjeç			Fëmijë / nipa / mbesa	
19-30 vjeç			Nipa / mbesa / kunata	
31-65 vjeç			Vëllezër / kunata	
Mbi 65 vjeç			Nëna	
			Gjithsej	

Shënim: Ju lutemi shënoni veçmas moshën e kryefamiljarit.

Sa anëtarë të rritur të ekonomisë familjare:

Nuk kanë ndjekur kurrë shkollë	
Kanë përfunduar shkollën fillore	
Kanë përfunduar shkollën e mesme	
Kanë përfunduar universitetin	
Kanë përfunduar studimet pasuniversitare (master ose doktoratë)	

Sa anëtarë të rritur të ekonomisë familjare janë:

Të punësuar	
Të papunë	
Nxënës/Studentë	
Pensionistë	

2. TË ARDHURAT

Në cilën nga kategoritë e mëposhtme bien të ardhurat totale mujore të ekonomisë suaj familjare ? Në rast se disa anëtarë të ekonomisë familjare fitojnë të ardhura, ju lutemi paraqitni shumën kumulative:

- Më pak se 100 euro
- 101-200 euro
- 201 – 350 euro
- 351 – 450 euro
- 451 – 500 euro
- 501 – 650 euro
- 651 – 750 euro
- 751 – 900 euro
- 901 – 1000 euro
- Më shumë se 1000 euro

Cilat janë burimet tuaja kryesore të të ardhurave:

Burimi	Rëndësia (1: Burimi më i rëndësishëm, 2: Burimi i dytë për nga rëndësia, 0: Burim me rëndësi të papërfillshme)
Paga	
Pensionet	
Prodhimi bujqësor	
Ndihmat nga qeveria apo ndihma të tjera	
Biznesi i vogël	
Puna e përkohshme apo sezonale	
Tregtia joformale	
Pagesat monetare nga jashtë (diaspora, puna jashtë vendit nga anëtarët e ekonomisë familjare)	
Përfitimet jo-monetare (p.sh., ndihma për ushqim, banim)	
Tjetër (tregoni konkretisht):	

Cilat nga më poshtë janë shpenzimet tuaja kryesore?

Ushqim	Banim (hipotekë/qira)	Shërbime komunale (ujë, energji elektrike, telefon)	Tjetër (tregoni konkretisht):	Kredi/Hua		
Arsim	Shëndet	Transport				

(1: shpenzimet më të larta, 2: shpenzimet e dyta më të larta, etj...)

Cili nga pohimet më poshtë përshkruan më mirë situatën tuaj financiare?

- a) Nuk kam të ardhura të mjaftueshme as për nevojat elementare
b) Kam të ardhura të mjaftueshme vetëm për nevojat elementare
c) Kam një nivel të lartë të të ardhurave

A ndryshojnë të ardhurat tuaja sipas stinëve të vitit?

Vërejtje apo komente:

3. CENUESHMËRIA

A ka ndonjë anëtarë të ekonomisë familjare që përballet me ndonjërin nga gjendjet e mëposhtme:	
	Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
Aftësi e kufizuar fizike	
Aftësi e kufizuar mendore	
Sëmundje kronike që kërkon trajtim të rregullt mjekësor	
Sëmundje kronike që kërkon shtrirje në spital	
Të gjithë anëtarët janë të papunë ose pa të ardhura të rregullta	
Ekonomia familjare përbëhet nga persona të moshuar dhe/ose të moshuar dhe beqarë	
Nëna vetushqyese me fëmijë të vegjël	
Përgjegjësi si ofruer kujdesi (kujdesi për anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara ose të moshuar me vetëm një burim të të ardhurave ose pa të ardhura)	
Problem tjetër (specifikoni)	

A përfiton ndonjë anëtar i ekonomisë familjare nga skemat e ndihmës sociale? Po/Jo

Nëse po, çfarë lloj ndihme përfiton? _____

PYETËSOR PËR BIZNESET

Numri referencës së pyetësit:	
Data e anketimit:	
Emri dhe mbiemri i anketuesit:	
Të plotësohet nga koordinatori i fushës:	
Pyetësi është kontrolluar nga:	
Data e verifikimit:	
Vendndodhja / Komuniteti Lokal:	

Adresa:	
Numri i parcelës kadastrale:	
Fotografi (numri referencës):	

Emri i plotë i respondentit:	
Tel. kontakti i respondentit:	
Pozicioni i respondentit në biznes:	

1. HYRJE

A jeni të informuar për Mekanizmin e Ankesave për Projektin?

A jeni informuar për shpronësimin e planifikuar? Nga kush? Kur?

A jeni të kënaqur me nivelin e informacionit të marrë deri më tani? (vlerësoni nga 1 deri 5, ku 1 është më i ulët)

Sipas mendimit tuaj, cila është mënyra më efektive për t'u informuar më shumë për detajet e këtij projekti? (p.sh., takime me përfaqësues komunalë, takime me Termokos, përmes takimeve publike, broshurave, gazetave ditore, radios, televizionit, ose ndonjë mënyrë tjetër?)

2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BIZNESIN E PREKUR

A funksionon biznesi gjatë gjithë vitit apo sezonalisht?			
A varet biznesi nga fluksi i lartë i kalimtarëve (trafiku i këmbësorëve) ose nga dukshmëria nga rruga?			
A e merr me qira hapësirën e biznesit apo e posedon (është pronar) i saj?			
Sipërfaqja totale (dhe përqindja e totalit) e parcelës që do të kufizohet/preket nga projekti:	_____ m ²	_____ % e totalit	
A është e tërë parcela e prekur:	PO / JO	Nëse JO, tregoni sipërfaqen e pjesës së prekur: _____ m ²	
Lloji i aktiviteteve të biznesit::			
Viti i themelimit:			
Pronari (bashkëpronari):			
Gjinia e pronarit:	M / F		
Biznesi a është formalisht i regjistruar:	PO / JO		
Forma ligjore e biznesit (nëse është formalisht i regjistruar):			
Statusi ligjor i strukturës së biznesit:	FORMAL ME LEJE / INFORMAL PA LEJE		
Numri i punonjësve			
Qarkullimi vjetor tipik:	_____		
Të ardhurat vjetore bruto tipike:	_____		
Fitimi vjetor tipik: (të ardhurat pas tatimeve)	_____		

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PUNONJËSIT

Emri i punonjësit	Niveli i arsimit dhe profesioni	Moshë	Gjinia		Vite të punës në biznes
			M	F	
1.			M	F	
2.			M	F	
3.			M	F	

Shënime dhe komente:

4. NDIKIMET E PROJEKTIT DHE KOMPENSIMI I PREFERUAR

Cilat elemente të biznesit mund të preken fizikisht nga Projekti?

Struktura e ndërtesës Parking / hapësirë ngarkimi Rrugë / qasje Shërbimet (ujë, energjia elektrike) Stoku ose inventari
Hapësirë për ulje jashtë ose hapësirë ekspozimi Tjetër

A ka ndonjë inventar, pajisje apo mobilie që mund të jetë e nevojshme të zhvendosen?

A do të ishte e mundur zhvendosja e përkohshme e biznesit tuaj gjatë ndërtimit?

A do të ishte e dobishme të merrni njoftim paraprak për punimet (p.sh., ndërprerje të qasjes, zhurmë)? Nëse po, sa kohë ju duhet për të rregulluar operimin e biznesit?

Çfarë mendoni se mund të jenë problemet kryesore për ju të shkaktuara nga projekti?

Zhvendosje e përhershme	Humbje e përkohshme e biznesit	Tjetër (specifikoni):	Tjetër (specifikoni):

(1: më e rëndësishme, 2: e dyta më e rëndësishme, etj. – 0: jo e rëndësishme ose jo e aplikuar)

Sipas mendimit tuaj, si mund të zgjidhen këto probleme?

Cili do të ishte kompensimi më adekuat për ju?

Kompensim në para	Ndihmë për zhvendosje:	Tjetër (specifikoni)	Tjetër (specifikoni)

4.4. Cilat janë planet tuaja pas Projektit?

Komentet dhe vëzhgimet e anketuesit (vështirësitë e hasura, vëzhgime shtesë, etj.)

4. INFORMACIONE PËR AKTIVITETET BUJQËSORE NË TOKËN E PLANIFIKUAR PËR IMPIANTIN TERMIC DIELLOR

Sa kohë ka që familja juaj e shfrytëzon parcelën e tokës ku është planifikuar ndërtimi i impiantit termik diellor?

A ekziston marrëveshje për shfrytëzimin e kësaj toke? A është me shkrim apo me gojë?

A ka pasur ndërprerje në shfrytëzimin e kësaj toke? Nëse po, kur, për sa kohë dhe pse?

Sa është sipërfaqja e tokës që e kultivoni?

A është e regjistruar ekonomia juaj familjare për prodhim bujqësor?

1. Po

- o A punësoni punëtorë? (sa: të punësuar me orar të plotë, të punësuar me orar jo të plotë, punëtorë sezonalë) OSE
- o Apo të gjitha aktivitetet kryhen nga anëtarët e ekonomisë familjare? (Nëse po, a janë të punësuar diku tjetër apo ky është profesioni i tyre i vetëm)

2. Jo

3. Jo, por planifikojmë të regjistrohemi

A merrni subvencione apo stimuj bujqësorë?

Me çfarë lloj prodhimi bujqësor merret ekonomia e juaj familjare në këtë parcelë?

Lloji i aktivitetit bujqësor	PO/JO	Nëse PO:	
		Shfrytëzimi (shënimi 1, 2 ose 3):	Rëndësia e aktivitetit për ekonominë familjare:
		1. Vetëm qëllime personale	1. Të ardhurat e tërë ekonomisë familjare varen nga ky aktivitet
		2. Vetëm për shitje	2. Aktiviteti është shumë i rëndësishëm për të ardhurat e ekonomisë familjare
		3. Si për qëllime personale ashtu edhe për shitje	3. Aktiviteti është më pak i rëndësishëm për të ardhurat e ekonomisë familjare
			4. Aktiviteti nuk është aspak i rëndësishëm
Prodhimi i perimeve	PO/JO		
Prodhimi i frutave	PO/JO		
Blegtoria	PO/JO		
Bletaria	PO/JO		
Tjetër (ju lutemi specifikoni)			

A përdorni mekanizim bujqësor apo pajisje të tjera në këtë lokacion? PO/JO

Nëse po, çfarë lloji?

A përdorni sistem ujitjeje në këtë parcelë (kjo përfshin çdo sistem që mund të preket gjithashtu nga implementimi i projektit)? PO/JO

- Kush e ka financuar ndërtimin e këtij sistemi?
- Kur është ndërtuar?

Të dhëna të tjera rreth aktiviteteve kultivuese

Çfarë mbillni? _____

Rendimenti i zakonshëm në këtë tokë është _____ kg

Sa për qind e ushqimit tuaj total sigurohet nga të prodhimi bujqësor? o 10% o 30% o 50% o 75% o 90% o _____

A e shitni atë që mbillni? o Po o Jo (nëse jo, kaloni pyetjet në vijim)

A janë të korrat burimi kryesor i të ardhurave? o Po o Jo

A janë të korrat burim dytësor i të ardhurave? o Po o Jo

A e shfrytëzoni tokën përreth dhe për çfarë aktiviteteve (i referohet rrethinave të parcelave të ekonomisë familjare)? Nëse po, a është toka:

- Private? nëse po: A jeni pronar i kësaj toke apo e merrni me qira? _____
- Publike? nëse po: A e merrni me qira këtë tokë (nëse po, a mund të jepni informacione rreth qirasë, si p.sh., qiradhënësi, periudha e qirasë, çmimi i qirasë, etj.) apo e shfrytëzoni atë në mënyrë joformale? _____

Të dhëna shtesë rreth shfrytëzimit të livadheve/kullotave

A i shfrytëzoni livadhet/kullotat dhe për çfarë qëllimi? _____

Të dhëna shtesë rreth blektorisë (mbarështimit të bagëtime)

A mbani kafshë? (cilat lloje? sa gjithsej?) _____

o Nëse po, për çfarë i përdorni kafshët?

(a) nevoja vetjake, b) shitje të produkteve, c) të dyja

Të dhëna shtesë rreth bletarisë

Sa koshere bletësh keni? (Ju lutemi përfshini çdo informacion lidhur me ndikimin e mundshëm nga implementimi i projektit.)

A i përdorni produktet e bletëve për:

a) nevoja vetjake, b) shitje c) të dyja

A posedon ekonomia familjare tokë tjetër bujqësore? PO/JO

Nëse po, ku?

A shfrytëzohet ajo tokë tjetër në mënyrë aktive për qëllime bujqësore?

5. INFORMIMI MBI PROJEKTIN**A jeni informuar lidhur me projektin? Nga kush? Kur?****Sa i qartë dhe i kuptueshëm ishte informacioni që morët për projektin?**

- Shumë i qartë
- I qartë
- Neutral
- I paqartë
- Shumë i paqartë

A jeni të kënaqur me nivelin e informacionit që keni marrë deri më sot? (vlerësoni nga 1 deri në 3, ku 3 është niveli më i ulët)

- 1- i kënaqur - informacionet janë të qarta, gjithëpërfshirëse dhe të dhëna me kohë
- 2- pjesërisht i kënaqur - disa informacione të dobishme, por ka boshllëqe ose detaje që mungojnë
- 3- i pakënaqur - informacionet janë të pamjaftueshme, të paqarta ose janë vonuar

*Nëse përgjigja është 2 ose 3, ju lutemi jepni shpjegoni.***Si do të dëshironit të informoheni më tej për projektin? (takime me komunitetin, materiale të shtypura, komunikim elektronik si email/SMS, takime individuale, etj.)****6. NDIKIMET NGA PROJEKTI DHE METODA E PREFERUAR E KOMPENSIMIT****Çfarë është perceptimi juaj për projektin?**

- a. Shumë pozitiv
- b. Pozitiv
- c. Neutral
- d. Negativ
- e. Shumë negativ

Cilat supozoni se mund të jenë problemet kryesore që mund të shkaktohen nga projekti (p.sh., humbja e mjeteve të jetesës, zhvendosja e aktivitetit bujqësor, etj.)?**Si mendoni se mund të zgjidhen problemet e përmendura?****A planifikoni të vazhdoni me aktivitetet tuaja bujqësore diku tjetër?****Cila është mënyra juaj e preferuar e kompensimit?**

Anëtari (mashkull) i ekonomisë familjare	<input type="checkbox"/> Kompensimi monetar
	<input type="checkbox"/> Qasja në tokë tjetër
	<input type="checkbox"/> Mundësi punësimi
	<input type="checkbox"/> Mundësimi aftësimi profesional
	<input type="checkbox"/> Tjetër (ju lutem specifikoni): _____
Anëtarja (femër) e ekonomisë familjare	<input type="checkbox"/> Kompensimi monetar
	<input type="checkbox"/> Qasja në tokë tjetër -
	<input type="checkbox"/> Mundësi punësimi
	<input type="checkbox"/> Mundësimi aftësimi profesional
	<input type="checkbox"/> Tjetër (ju lutem specifikoni): _____

Cili mendoni se do të ishte kompensimi më adekuat për ju?

Çfarë lloj mbështetjeje shtesë mendoni se do t'ju nevojitet?

Ndihmë financiare

Mundësi për aftësim profesional apo punësim

Ndihmë për zhvendosje

Tjetër

Cilat janë planet tuaja pasi të mos jeni më në gjendje ta shfrytëzoni këtë parcelë?

A ka ndonjë çështje apo shqetësim tjetër që dëshironi të ngrini?

Vërejtjet dhe komentet e anketuesit (vështirësitë e hasura, vërejtje shtesë, etj.)

SHËNIME TË RËNDËSISHME PËR ANKETUESIT: Gjatë realizimit të anketës, rekomandohet që për anketën socio-ekonomike të jenë të pranishëm anëtarët e ekonomisë familjare të të dyja gjinive (p.sh., burri dhe gruaja), pasi pyetësi kërkon përgjigje si nga të dyja palët.

Shtojca 4: Formulari i pëlqimit për të dhënat personaleKosovo: GrCF2 W2 E2 – Pristina Solar District Heating
Socio-Economic Survey

I, _____ (name and surname), personal identification No. _____, inhabited in _____ (street name and number, settlement, municipality) as a respondent I voluntarily give this:

WRITTEN CONSENT FOR THE PROCESSING AND USE OF PERSONAL DATA

By my signature I confirm that I have been clearly informed by the representative of *NP TERMOKOS SH.A.*, address at 28 ~~Njëtori~~ No.181, 10000 Prishtina, (hereinafter the controller) of the reasons for collecting personal data and giving this written consent in accordance with Article 6 of the Law No. 06/L –082, on Protection of Personal Data (Official Gazette No. 6/25 of the Republic of Kosovo, February 2019), in order to implement the Project Kosovo: GrCF2 W2 E2 – Pristina Solar District Heating.

In this regard, I voluntarily give my consent that the controller can process and use my personal data, and that it may submit it to the *NP TERMOKOS SH.A.* (address: 28 ~~Njëtori~~ No.181, 10000 Prishtina), only for the purpose listed above. Personal data that I consent to be subject to processing by *NP TERMOKOS SH.A.*, are: name and surname, year of birth, sex, address of residence, e-mail address, telephone/mobile contact number, ethnicity, level of education, health condition, financial conditions or living conditions, employment, type and number of identification document. This consent extends also to any video(s) and/or photo(s) taken of me during the survey.

I am informed by the controller that at any time, in full or in part and free of charge, I am free to withdraw my Written Consent by submitting a notice to the *NP TERMOKOS SH.A. – Project Implementation Unit*, at the address at 28 ~~Njëtori~~ No.181, 10000 Prishtina, Kosovo, or via e-mail: info@TERMOKOS.org; solar4kosova@TERMOKOS.org, phone number: +383 38 541780. Also, I am aware that the controller will keep my personal data for as long as necessary to fulfil the purpose for which they are processed, unless the controller is bound by additional legal deadlines for their storage.

Withdrawal of this Written Consent will not affect the legality of processing before you withdrew the consent.

My questions have been answered to my satisfaction, and I agree to participate in this survey and give this Written Consent. I am over the age of 18 years and hereby certify via my signature that I have been informed with the content of the survey.

Name of the Respondent (handwritten): _____

Signature of the Respondent: _____

Date and time of signature: __. __. 2024, at __ h __ min

The legal basis for the collection, processing and storage of personal data is your voluntary written consent given by signing this statement. By signing this statement, you consent to the further processing of your personal data that you will provide in the survey questionnaire that is an integral part of this statement. The collection, use and processing of personal data is necessary for the purpose of implementing the Project Kosovo: GrCF2 W2 E2 – Pristina Solar District Heating in the public interest.

The information within this project will only be used in ways that will not reveal who you are. You will not be identified in any of the publications within this Project and your identity as a Project participant is confidential.

Your data will be protected from unauthorized access or misuse and will be handled in accordance with legal requirements and appropriate security measures.

Legal Basis:
Conditions for consent – Article 6; Lawful processing of personal data – Article 5, paragraph 1.1 and 1.5; Processing of special categories of personal data – Article 8, paragraph 2.1 and 2.7; Information to be provided where personal data are collected from the data subject – Article 12, paragraph 1.1, 1.3, 1.6, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 of the Law No. 06/L –082, on Protection of Personal Data (Official Gazette No. 6/25 of the Republic of Kosovo, February 2019).

Surveyor's Statement: In my judgement the respondent is voluntarily and knowingly giving informed consent and possesses the legal capacity to give informed consent to participate in this socio-economic survey (study).

Name of the Surveyor (handwritten): _____

Signature of Surveyor: _____

